



## Zhvillimi Ekonomik ◀ Arsimi Profesional ▶ Mirëqënie për Shqipërinë

### Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Kombëtare 22 Tetor 2013, Tiranë

Roland Çela  
Elsa Denaj  
Arnold Geiger  
Frank Hantke  
Sabine Hartig  
Winfried Heusinger  
Anette Kasten  
Sonila Limaj  
Reiner Reidenbach



Deutsche Industrie- und  
Handelsvereinigung in Albanien  
Shoqata Gjermane e Industrisë dhe  
Tregtisë në Shqipëri



Në bashkëpunim me:

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



**Zhvillimi Ekonomik ◀ Arsimi Profesional ▶ Mirëqënie për Shqipërinë**

**Rezultate dhe Rekomandime  
të Konferencës Kombëtare  
22 Tetor 2013**

Roland Çela  
Elsa Denaj  
Arnold Geiger  
Frank Hantke  
Sabine Hartig  
Winfried Heusinger  
Anette Kasten  
Sonila Limaj  
Reiner Reidenbach

**Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Kombetare:**

**“ZHVILLIMI EKONOMIK ▶ ARSIMI PROFESIONAL ▶ MIRËQËNIE PËR SHQIPËRINË”**

**Botimi i broshurës u mundësua nga:**

**Fondacioni “Friedrich Ebert”**

Zyra e Tiranës

Rruga: “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 2273306; Fax: +355 04 2262067

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Viti i botimit: 2014

Përkthyer nga:

Adelina Albrahimi (Anglisht – Shqip)

Sonila Limaj (Gjermanisht – Shqip)

Redaktoi:

Frank Hantke, Jonida Smaja

*Publikimet e FES-it nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim!*

## Rekomandimet e konferencës

### 1. Shfrytëzimi i burimeve të vendit

Shqipëria ka një sërë burimesh natyrore. Këto burime duhen shfrytëzuar me prioritet dhe sa më efektivisht të jetë e mundur duke mbështetur krijimin e një rrjeti të koordinuar të këtyre burimeve. Ndër këto burime mund të përmenden:

- Uji, era, dielli:** Nga këto tri burime mund të krijohen mundësi të larmishme të prodhimit të energjisë. Në këtë mënyrë Shqipëria do të plotësojë jo vetëm nevojat e veta, por mund të shndërrohet në një eksportuese rajonale të energjisë.
- Bujqësia:** Bujqësia shqiptare ende nuk i ka shfrytëzuar potencialet e veta. Me një organizim më të zgjuar e më kompetent si dhe nëpërmjet përpunimit të certifikuar të prodhimeve, rendimenti mund të ishte shumë më i lartë dhe i përqendruar tek eksporti.
- Larmia e natyrës dhe e specieve:** Gati asnjë vend tjetër evropian nuk ka në një hapësirë kaq të vogël një natyrë kaq të larmishme sa Shqipëria. Kjo pasuri, nëse zhvillohet në një turizëm ekologjik dhe të qëndrueshëm, do të sjellë fitime sistematike e gjithnjë në rritje.
- Industria e lehtë:** Vendi ka një traditë, sidomos në sektorin e industrisë përpunuese të lëkurës dhe tekstileve. Me investime të qëllimta mund të ngrihet një sektor i suksesshëm dhe me fitim - edhe në fushën e zejeve.
- Minerale të çmuara:** Rezervat ekzistuese shfrytëzohen me teknologji të vjetëruara dhe në mënyrë të pamjaftueshme. Me investime të qëllimta për modernizimin dhe kombinimin (gërshtetimin) me përpunimin mund të sigurohen fitime më të larta.

### 2. Koncept i plotë për zhvillimin e Shqipërisë

Për të shfrytëzuar në mënyrë efektive potencialet ekonomike është e nevojshme që investimet publike afatmesme dhe afatgjata të përmbliohen në një koncept të plotë. Ky koncept i plotë mund të formulohej si strategji “Shqipëria 2020”. Aspekte thelbësore të këtij vizioni mund të jenë:

- Shërbime me në qendër klientin:** Bota e ekonomisë moderne e bazon ekzistencën e saj në shërbime funksionale. Sektori i shërbimeve është një sektor lateral, i cili prek të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë.
- Administrim eficient** – në të gjitha nivelet – dhe “rule of law” (shteti i së drejtës): Një ekonomi mund të rritet në mënyrë të rregulluar, vetëm nëse bëhen investime. Por investitorët kanë nevojë për garanci për sa i përket administrimit kompetent dhe sigurisë ligjore.
- Rregullimi i çështjes së pronës:** Çështjet e pronës ende mbeten të pasqaruara. Kjo bllokon ngritjen e ekonomisë dhe pengon investimet. Bazuar në modele të suksesshme nga vende të tjera në tranzicion mund të gjenden zgjidhje sociale të qëndrueshme (solide).
- Sistem modern i arsimit i orientuar drejt profesioneve:** Sistemi arsimor nuk është objekt i tregut të lirë. Shteti duhet të garantojë një sistem arsimor funksional dhe modern, i cili u përgjigjet nevojave shoqërore dhe ekonomike.
- Konsolidimi i infrastrukturës:** Konsolidimi i infrastrukturës së vendit është një masë e domosdoshme dhe e shumanshme për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë. Këtu nevojitet ndërhyrje në furnizimin me energji elektrike, menaxhimin e mbetjeve, të ujit të pijshëm e ujërave të zeza apo edhe të trafikut rrugor.
- Sistemi i mbështetjes sociale:** Si anëtar në perspektivë i BE-së, Shqipëria duhet të sigurojë standardet minimale të kujdesit social. Këto standarde përfshijnë edhe kujdesin shëndetësor dhe kujdesin për të moshuarit apo një sistem funksional shëndetësor në tërësi.

### 3. Strategji për veprim të koordinuar

Të gjitha ministrat dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorëve privatë duhet të përshkruajnë detyrat e një strategjie publike për zhvillimin e Shqipërisë me një të ashtëquajtur “road map” me qëllim realizimin dhe kontrollin e këtij zhvillimi.

- Partneritet me ekspertë të huaj:** Në këtë projekt për realizimin e konceptit duhet të përfshihen qysh në fillim të procesit partnerët ndërkombëtarë të bashkëpunimit me përvojat e tyre specifike në vendet në tranzicion.
- Shfrytëzimi i të gjitha mundësive financiare:** Për këtë duhen ngritur sa më shpejt kapacitete institucionale dhe kompetenca individuale ekspertize dhe menaxhimi, për të shfrytëzuar plotësisht të gjitha fondet e vëna në dispozicion nga BE-ja.

### 4. Bashkëpunim i ngushtë ndërmjet shtetit dhe biznesit privat

Në një ekonomi moderne bashkëpunimi kuptimplotë ndërmjet shtetit dhe aktorëve ekonomikë është domosdoshmëri. Sektori privat mban një pjesë të madhe të përgjegjësisë për zhvillimin e një vendi. Për këtë arsye, ky sektor duhet përfshirë në mënyrën e duhur në çdo drejtim, ku nga ky bashkëpunim mund të lindë zhvillimi. Kjo është në interes të të dyja palëve.

- Një fushë kyçe dhe e domosdoshme **bashkëpunimi** është kualifikimi profesional, duke filluar nga arsimi profesional fillestar deri në kualifikimet e mëtejshme në punë dhe rikualifikim.
- Këtu shteti duhet të ndërtojë **kushtet e nevojshme**, për shembull, në shkollë, ndërsa **biznesi duhet të marrë përgjegjësi për lidhjen përmbajtësore dhe praktike me botën e punës**.
- Politikë aktive punësimi**, e cila lidh në mënyrë efektive nevojat e biznesit me qëllimet e punëkërkesve, nëpërmjet këshillimit cilësor dhe masave mbështetëse (informimit rreth ofertave për kualifikim profesional).

### 5. Përshkrimi i profesioneve dhe kualifikimeve

Burime njerëzore: Fuqia punëtore në Shqipëri është shumë e re. Por në tërësi mungon kualifikimi profesional në të gjitha nivelet e ekonomisë. Me një kualifikim profesional të mirë dhe të fokusuar mund ngrihen dhe të konsolidohen siç duhet sektorët ekonomikë. Në këtë mënyrë garantohet punësimi i rregullt. Një rrjedhë e mundshme e bashkëpunimit të domosdoshëm ndërmjet shtetit dhe sektorit privat për zhvillimin e fuqisë së kualifikuar punëtore në sektorin akademik dhe jo akademik mund të ishte:

- Profesione kyçe:** Identifikimi dhe ripërkufizimi në kushtet moderne i profesioneve më të rëndësishme dhe të domosdoshme në sektorët kyçë me perspektivë të ekonomisë shqiptare.
- Kurrikula të orientuara në praktikë:** Hartimi në bashkëpunim i përmbajtjeve të kualifikimeve dhe kurrikulave për kualifikim profesional të integruar në shkollë dhe në praktikë.
- Kontrolli (i cilësisë):** Monitorimi i përbashkët – p.sh. në komisionet e provimeve – i respektimit të standardeve dhe përmbajtjeve të vendosura.
- Çertifikimi:** në mënyrë që të krijohet një potencial i specialistëve të kualifikuar me kualifikime detyruese, të cilat t’u përgjigjen edhe standardeve ndërkombëtare.

### 6. Kurrikula sipas sistemit dual në të gjitha nivelet profesionale

Arsimi profesional me perspektivë duhet të ketë si parim bazë bashkëpunimin më të ngushtë ndërmjet shkollave profesionale dhe kompanive. Të rinjve duhet t’u jepet mundësia ta njohin botën e punës qysh gjatë kohës së arsimimit në mënyrë që të përgatiten më mirë për tregun. Në përgjithësi është e nevojshme që arsimit dhe formimit profesional të orientohen drejt praktikës dhe të integrohet më mirë gërshtimi i praktikës me teorinë. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet arsimit dhe biznesit është i pashmangshëm kur bëhet fjalë për përcaktimin e kërkesave dhe drejtimeve të kualifikimeve:

- Kriteret e praktikës:** Biznesi është ai që mund ta vlerësojë më mirë se kushdo tjetër, cilat kërkesa janë të domosdoshme për ushtrimin e cilit profesion dhe në cilat kushte.
- Integrimi:** I cili vlen si për përmbajtjet teorike, ashtu edhe për aspektet praktike të arsimit. Dhe ky parim duhet të vlejë për nivelet e ulëta dhe të larta të kualifikimit profesional
- Sistem me nivel:** Në përputhje me të duhet të parashikohet kohëzgjatja e niveleve të arsimit (p.sh. gjysmë viti për kualifikimet bazë, një deri në një vit e gjysmë për kualifikimet e mesme etj.) dhe çdo nivel të mbyllet me certifikimin e përbashkët.
- Nivel ndërkombëtar:** Element bashkëpërcaktues i të gjitha niveleve të arsimit duhet të jenë standardet ndërkombëtare për shumë kualifikime profesionale (p.sh. aftësia për respektimin e normave të njohura ndërkombëtarisht).

## 7. Mbulim i plotë i sistemit nëpërmjet qendrave multifunkionale (QMF)

Oferta e kualifikimeve për arsimin profesional në Shqipëri ende nuk e mbulon të gjithë vendin dhe nuk ofrohet në të njëjtën mënyrë kudo. Shumë zona, posaçërisht ato rurale janë shumë larg për t'u ofruar të rinjve perspektivë. Në terma afatgjatë sistemi i arsimit profesional duhet të jetë zgjidhje për problemet kryesore aktuale:

- Qendrat multifunkionale:** Oferta e tyre e plotë në nivele të ndryshme të kualifikimeve profesionale është mundësia më e mirë për zhvillimin cilësor të ofertës.
- Shanse për të gjithë:** Të gjithë të rinjve me dëshirë për t'u arsimuar duhet t'u ofrohet mundësia të përvetësojnë një kualifikim. Për të gjetur ekuilibrin ndërmjet qytetit dhe fshatit, në zonat rurale mund të ofrohet arsimi profesional fillestar, i cili mund të konsolidohet më tej. Arsimi profesional nuk duhet të mbetet një çështje e mundësive financiare të nxënësve dhe prindërve. Për këtë arsye të rinjve me dëshirë për t'u arsimuar duhet t'u krijojnë mundësi për të jetuar në konvikt, veçanërisht në ato raste kur në vendbanimet e tyre mungon oferta arsimore.
- Kualifikime të shpejta:** Për rigjallërimin e ekonomisë dhe konsolidimin e qëndrueshëm të saj në të gjithë sektorët me perspektivë duhet të ketë fuqi punëtore të kualifikuar. Ndaj paralelisht duhen menduar iniciativa për kualifikimin afatshkurtër në qendrat multifunkionale të arsimit profesional në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë, të cilat aktualisht kërkojnë punonjës.

## 8. Këshillimi për karrierë si element i politikës aktive të tregut të punës

Anketime domethënëse dëshmojnë se të rinjtë – dhe po ashtu prindërit e tyre – nuk kanë thuajse fare informacion se ç'mundësi dhe rrugë profesionale mund të jenë të përshtatshme dhe me perspektivë për ta. Informacionet rreth nevojave të biznesit janë thuajse fare të panjohura dhe thuajse nuk komunikohen fare publikisht. Pikërisht për këtë është i domosdoshëm bashkëpunimi ndërmjet biznesit privat dhe politikës shtetërore të tregut të punës, në interes dypalësh. Për të zbutur këtë mangësi, mund të mendohen këto masa të realizueshme në një afat të shkurtër kohor:

- Shkëmbim më i plotë dhe më i përditësuar i informacionit** ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve shtetërore rreth nevojave aktuale por edhe për të ardhmen.
- Zyra informacioni apo aktivitete informacioni** nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe zyrat rajonale të tij për prindër dhe nxënës në shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme si instrumente ndihmëse në vendimmarrjen dhe planifikimin e karrierës profesionale nga të rinjtë.
- Sistem këshillimi për studentët e rinj** rreth ndjekjes së studimeve në degë të caktuara në konsultim me shkollat e larta dhe biznesin privat.
- Përfshirja në programet e studimit e **praktikave të integruara**, për të korrigjuar apo për të specifikuar më mirë drejtimin e studimeve të ndjekura.
- Këshillim për punëmarrës të papunë** rreth mundësive të ritrajnimit apo kualifikimeve të mëtejshme, për të mundësuar ose për të rritur shanset e tyre të punësimit.

## 9. Arsimim i bashkërenduar për ekonominë e së ardhmes

Politika e arsimit dhe e formimit nga kopshti deri në shkollë të lartë ka vuajtur nga probleme të ndryshme. Këto probleme janë edhe përgjegjëse për zhvillimin e cunguar të arsimit dhe formimit kur është fjala për vlefshmërinë profesionale të tyre. Mundësi zgjidhjeje mund të jenë:

- **Zbutja e hendekut qytet-fshat:** Oferta edukuese dhe arsimore në zonat rurale ka ekzistuar në nivele minimale, çka ka sjellë edhe degradimin e biznesit në këto zona. Shumë familje shpërngulen në qytete, sepse dëshirojnë t'u ofrojnë fëmijëve të tyre mundësi më të mira arsimimi dhe profesionale. Ky trend duhet të ndalet, sepse së pari qytetet asnjëherë nuk ofrojnë mundësitë, për të cilat shpresojnë të ardhurit (migrantët). Së dyti, zonat rurale duhet të rigjejnë lidhjen me zhvillimin ekonomik të vendit.
- **Cilësi përpara sasisë:** Në dobi të një rritjeje të shpejtë të mundësive të edukimit dhe arsimit, sidomos në arsimin privat, është hequr dorë nga pretendimet për cilësi, ose kërkesat për cilësi janë lënë pas dore nga monitorimi i pamjaftueshëm. Institucionet arsimore ekzistuese duhet të monitorohen për respektimin e standardeve të cilësisë. Nëse i përmbushin këto standarde, ato mund të akreditohen por gjithmonë duke iu nënshtuar monitorimit të rregullt për ruajtjen e standardeve.
- **Zhvillim simetrik** i programeve akademike dhe atyre jo akademike. Me një fokusim të gjerë të rritjes së shpejtë të numrit të vendeve të studimeve të larta u thellua edhe më tepër përshtypja se përfundimi i studimeve të larta ishte gati-gati i pashmangshëm për sukses në karrierën profesionale, duke bërë që të rinjtë dhe prindërit e tyre të marrin vendime të gabuara, vendime të cilat në të shumtën e rasteve shkaktojnë zhgënjim dhe frustrim – edhe në ekonomi. Duhet gjetur mundësi integrimi të aspekteve nga bota e punës në arsimin bazë dhe atë të mesëm, sidomos nëpërmjet përvojave të drejtpërdrejta në botën e punës. Këto duhen shoqëruar edhe me politika informimi të përditësuara rreth perspektivave profesionale në të gjitha nivelet.
- **Forcimi i ofertës publike** të mundësive të arsimit jo akademike. Për shkak të përqendrimit qartazi në arsimin e lartë universitar nuk janë mbështetur mjaftueshëm as ato alternativa arsimore jo akademike për t'i shndërruar në alternativa reale për të rinjtë. Pikërisht kjo duhet vënë sa më shpejt në rrugë të mbarë. Përbri këtyre masave mund të mendohen edhe fushata sensibilizuese dhe sqaruese.
- **Të nxënit nëpërmjet proceseve:** Duke marrë parasysh botën profesionale në ndryshim të vazhdueshëm dhe rritjen shpërthyesë të informacionit, fokusimi në përvetësimin e thjeshtë të fakteve nuk është më i mjaftueshëm. Nëpërmjet përmbajtjes së programeve të arsimit duhet të synohet aftësia për të identifikuar dhe ndërtuar procese dhe për t'u përballur me kërkesat e së ardhmes. Kjo do të jetë një përgjigje ndaj kushteve specifike në Shqipëri, ku të nxënit sipërmarrës (entrepreneurial learning & culture) për shkak të numrit shumë të madh të bizneseve mikro dhe të vogla duhet të jetë një gur themeli në arsimin në shkollë dhe më pas në formimin profesional.

## Përmbajtja

<b>Rezultatet e Konferencës</b>	3
Parathënie, Hellmut Hoffmann, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë	8
Shënim i organizatorëve	9
Programi i konferencës	10
Erion Veliaj, Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	11
Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	12
Gentjana Sula, Zv. Ministre e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	13
Diana Çuli, Shkrimtare	14
Paneli: Shërbimet / Tregëtia	15
Paneli: Agrobiznes / Teknologji Ushqimore	16
Paneli: Prodhim/ Industri	19
Paneli: Infrastrukturë / Konstruksion / Logjistikë	21
Prezantim: Qendra Multifunkionale e Kamzës - Partner në industrinë e trajnimit profesional, transferimit të teknologjisë dhe shërbimeve	23
Prezantim: PASO në Shkolla- lidhja e parë me biznesin / komunitetin	24
Prezantim: “Mendimtarët” dhe “Praktikët” të Përfshirë në Sistemin Dual	25
Prezantim: Të Nxënësit Bazuar në Projekt Sabine Hartig	26
Sistemi Dual dhe Çfarë Mund të Mësojmë prej tij	27
Apel për një Vullnet të Mirë	29
Foto të Konferencës	31

## Parathënie

Hellmut Hoffmann

Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri



Konferenca “Zhvillimi Ekonomik – Arsimi Profesional – Mirëqenia në Shqipëri”, qysh në titullbën bashkë tri fjalë kyçe për zhvillimin e Shqipërisë. Falë organizatorëve dhe partnerëve të shumtë nga fusha e arsimit profesional u ftuan dhe morën pjesë në këtë konferencë përfaqësuesit më të rëndësishëm të ekonomisë, politikës dhe arsimit, pasi vetëm një bashkëpunim intensiv i këtyre aktorëve do të mund të krijojë kushtet për një arsim cilësor e me perspektivë në shërbim të një rritjeje të qëndrueshme në vend.

Ekonomia shqiptare është në rritje, por jo në ato nivele që mund të ishte. Shqipëria ka një potencial të madh, jo vetëm falë burimeve natyrore.

Shqipëria është një vend ambicioz me popullsi në moshë të re në rrugën drejt Bashkimit Evropian, rrugë të cilën mund ta përfundojë me sukses, por duke mobilizuar dhe koordinuar të gjitha forcat. Gjermania e mbështet zhvillimin ekonomik të Shqipërisë nëpërmjet një partneriteti 25-vjeçar dhe do ta vazhdojë këtë mbështetje edhe në të ardhmen. Tekefundit synimi i secilit prej nesh është Evropa e bashkuar, në të cilën Shqipëria të ketë vendin që meriton.

Ekonomia gjermane mund të kthejë kokën pas e të konstatojë dekada suksesi. Një faktor kryesor i suksesit të saj ka qenë gjithmonë kualifikimi i njerëzve në të gjitha fushat e ekonomisë. Produkte cilësore dhe shërbime efektive mund të ofrohen vetëm nëse të punësuarit e realizojnë punën e tyre me nivelin më të lartë të cilësisë. Për këtë qëllim, në Gjermani ne kemi ngritur një sistem kualifikimi, i cili mbahet dhe përmirësohet nga të gjithë aktorët në ekonomi, politikë dhe në arsim. Thelbi i këtij kualifikimi është parimi dual. Në të gjitha nivelet e kualifikimit, teoria dhe praktika lidhen në mënyrë të tillë që të rinjtë të përgatiten që sot të ofrojnë cilësi në punë dhe nesër të ndërtojnë bashkë me politikëbërësit qasje të reja. Kjo formë e arsimit profesional zhvillohet me sukses prej kohësh edhe në Austri dhe në Zvicër, ndaj është kënaqësi që këtë përvojë shumëvjeçare t’ia përcjellim Shqipërisë.

Në konsultimet tona të përvitshme rreth bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë, bisedohet vazhdimisht rreth kualifikimeve të nevojshme në administratë, në sektorin e shërbimeve, në zeje dhe në prodhim. Në këta sektorë, Shqipëria ka ende deficite. Ky është një konstatim i investitorëve, por edhe i vetë politikës shqiptare. Ndaj e përsëritës vendosmërinë e qeverisë së re për t’u angazhuar me energji në zgjidhjen e këtyre problemeve. Kjo vendosmëri u shpreh qartë edhe në fjalën e zotit Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe të Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Industrisë dhe Sipërmarrjes, të pranishëm në konferencë.

Fjala është për çështje të rëndësishme si respektimi dhe zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve administrative, për një administratë publike kompetente dhe efektive dhe një linjë të qartë politike për zhvillimin ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ndaj duhen zgjuar e bashkuar të gjitha forcat.

Rezultatet e konferencës do të jenë hapi i parë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik. Unë i inkurajoj të gjithë partnerët, të hedhin hapa të mëtejshëm në të ardhmen.

## Shënim i organizatorëve



Interesi i madh për zhvillimin e qëndrueshëm social të ekonomisë shqiptare bashkon përpjekjet e Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) dhe të fondacionit Friedrich Ebert (FES). Ky interes i ka shtyrë të dy këto organizata të iniciojnë një konferencë të përbashkët, e cila nga njëra anë mori përsipër të trajtonte mungesën e madhe të punonjësve të specializuar në tregun e punës dhe nga ana tjetër të nënvizonte shifrat e larta të papunësisë të rinjtë. Të dyja këto tematika në këtë konferencë u trajtuan në kuadrin e një reforme të gjerë të arsimit me karakter profesional.

Mbi 250 pjesëmarrës nga politika, biznesi dhe arsimi u bashkuan për të diskutuar rreth detyrave, synimeve dhe mundësive për përmirësimin e arsimit profesional. Qysh në fillim të konferencës, qeveria e re u tregua shumë e hapur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë. Të dy ministrat Erion Veliaj (Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë) dhe Arben Ahmetaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes) prezantuan idetë e para të një reforme rrënjësore.

Konferenca ishte konceptuar në formën e një ëorkshop-i, në mënyrë që ekspertë nga fusha të ndryshme të shkëmbenin përvoja dhe të diskutonin. Në këto diskutime u theksua edhe një herë se një reformë e madhe mund të realizohet vetëm me përfshirjen e të gjitha palëve. Veçanërisht përfaqësuesit e pranishëm nga biznesi privat theksuan interesin e tyre për të qenë pjesë e strukturimit të arsimit profesional, pasi bashkëpunimi i tyre do të jetë një gur kilometrik, i domosdoshëm dhe kuptimplotë për reformën.

Bashkëpunimi mund të jetë në hartimin e kurrikulave, por edhe në pajisjen profesionale dhe moderne të bazave të praktikës, qoftë në shkollat profesionale, në qendrat e formimit profesional apo qendrat multifunksionale të arsimit profesional. Kualifikimi profesional dual, i cili gërsheton specifikisht teorinë me praktikën, ka nevojë domosdoshmërisht për bashkëpunimin e praktikuesve të biznesit dhe të mësuesve e politikbërësve të arsimit.

Ofruesit e projekteve në arsimin profesional nga Gjermania, Austria dhe Zvicra prezantuan projektet e tyre si në diskutimin e konferencës, ashtu edhe në “tregun e mundësive”, ku mësues dhe nxënës konkretizuan prezantimin e projekteve.

Të gjithë të rinjtë pjesëmarrës në konferencë treguan interes të singertë, sepse, tekefundit u diskutua për ndërtimin e së ardhmes së tyre. Këta të rinj kërkojnë perspektiva premtuese, përtej karrierave të saponisura dhe jo gjithmonë të suksesshme. Ata e dinë shumë mirë çfarë iu mungon, sepse punëdhënësit e theksojnë gjithnjë e më shpesh në intervistat e punës se diplomat e studimeve të

tyre nuk janë të përshtatshme për aktivitetin profesional në fusha të ndryshme. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e tyre nuk duan ose nuk mundin të fillojnë studimet, duke mos pasur perspektivë në treg. Por të rinjtë kërkojnë punë të denjë në marrëdhënie të siguruara.

Zhvillimi ekonomik në të gjitha vendet e suksesshme e tregon qartë se bazohet në potencialin e punonjësve specialistë nga të gjitha fushat. Pikërisht për këtë duhet të punohet duke pasur si bazë rekomandimet e kësaj konference.

**Anette Kasten**

**DIHA**

**Frank Hantke**

**FES**

## Programi

### Mirëseardhja

<p><b>09.00 Fjalë përshëndetëse</b>  <i>Anette Kasten</i>, Drejtore Ekzekutive, DIHA  <i>Frank Hantke</i>, Drejtor, FES, Zyra e Tiranës                  Moderatore: <i>Jonida Smaja</i>, FES, zyra e Tiranës</p> <p><b>09.10 Fjalë përshëndetëse</b>  <i>Hellmut Hoffmann</i>, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë</p> <p><b>09.25 Adresim i prioritetëve, Trajnimi Profesional</b>  <i>Erion Veliaj</i>, Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë</p>	<p><b>09.40 Adresim i prioritetëve, Zhvillimi Ekonomik</b>  <i>Arben Ahmetaj</i>, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes</p> <p><b>10.00 “Unë kam një ëndërr! – Vizioni im për një Shqipëri më të mirë”</b>  <i>Diana Çuli</i>, Shkrimtare</p>
---	--

### Sfidat Ekonomike – Çfarë posedojmë, ku duam të shkojmë, çfarë na nevojitet?

<p><b>10.40 Paneli 1: Shërbimet / Tregëtia</b>                  Prezantues: <i>Zak Topuzi</i>, Hotel Mondial, <i>Arian Gjorgja</i>, Megatec                  Komentues: <i>Flutura Vaqarri</i>, Shkolla “Hoteri – Turizëm”                  Mikpritës: <i>Sonila Limaj</i>, Kulturkontakt</p> <p><b>11.40 Paneli 2: Agrobiznes/Teknologjia Ushqimore</b>                  Prezantues: <i>Aida Nani</i>, Agro-përpunim/  <i>Piro Rapushaj</i>, Shoqata Shqipëtare e Konkurrencës të Agrikulturës                  Komentues: <i>Ilir Mehmeti</i>, Shoqata Shqiptare e Vajit të Ullirit                  Mikpritës: <i>Roland Çela</i>, GIZ</p>	<p><b>Paneli 3: Prodhim / Industri</b>                  Prezantues: <i>Ermal Rula</i>, “Europa Metal Construction”                  Komentues: <i>Bashkim Shkembj</i>, Shkolla “Beqir Çela”, Durrës and <i>Prof. Enkeleda Sotja</i>, Universiteti Politeknik i Tiranës                  Mikpritës: <i>Winfried Heusinger</i>, GIZ</p> <p><b>Paneli 4: Infrastrukturë / Ndërtim / Logjistikë</b>                  Prezantues: <i>Carsten Conrad</i>, “Tirana Business Park”, <i>Sonila Rada</i>, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA)                  Komentues: <i>Jens Ströber</i>, Ems APO                  Mikpritës: <i>Anette Kasten</i>, Drejtore Ekzekutive, DIHA</p>
---	---

### Iniciativa të Edukimit dhe Trajnimit – Çfarë ofrohet dhe si funksionon?

<p><b>14.00 Rezultatet kryesore të diskutimeve në panele</b>  <i>Jonida Smaja</i>, FES</p> <p><b>14.15 Prezantim: “Të bëhemi konkurrues me aftësi, shprehi dhe produktivitet”</b>  <i>Gentjana Sula</i>, ZV. Ministre e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë</p> <p><b>14.40 Prezantim: “Qendra Multifunkionale e Kamzës – Partner në industrinë e trajnimit profesional, transferimit të teknologjisë dhe shërbimeve”</b>  <i>Rainer Reidenbach</i>, GIZ</p>	<p><b>15.00 Prezantim: “PASO në shkolla – lidhja e parë me biznesin / komunitetin”</b>  <i>Elsa Denaj</i>, Kulturkontakt</p> <p><b>15.20 Prezantim: “Mendimtarët” dhe “Praktikët” të përfshirë në sistemin dual</b>  <i>Arnold Geiger</i>, Drejtor Ekzekutiv, Nehemiah Gateway</p> <p><b>15.40 Diskutim me Panelin: “Të nxënësit bazuar në projekt”</b>  <i>Eriola Shingjergji</i>, <i>Maksim Konini</i>, <i>Stephan Leiser</i>, Swisscontact</p>
--	---

### Si duhet të vazhdojmë më tej? – Prioritetet dhe Objektivat tona të së ardhmes

<p><b>16.20 “Sistemi dual dhe çfarë mësojmë prej tij”</b>  <i>Sabine Hartig</i>, Drejtuese e programit për Trajnimin dhe Arsimin Profesional, GIZ</p>	<p><b>16.45 Rezultatet e para të konferencës – bashkëpunim dhe strategji</b>  <i>Frank Hantke</i>, Drejtor, FES – zyra e Tiranës</p>
---	--

## Adresimi i prioriteteve, Trajnimi Profesional

Erion Veliaj

Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë



Që në fillim dua t'ju falenderoj për kohën tuaj, sepse kur dikush fal kohën e vet do të thotë se i ka dhuruar një kauze një pjesë të jetës së tij. Disa prej jush kanë dhuruar kohën e tyre sot për një kauzë të cilën ne e konsiderojmë shumë të rëndësishme.

Në fakt, disa nga ju i kanë dhuruar disa vite të jetës tuaj profesionale kësaj kauze, prandaj dua t'i falenderoj shumë përfaqësuesit e shkollave profesionale, mësuesit dhe drejtuesit, të cilët me motivimin dhe pasionin e tyre e kanë mbajtur gjallë këtë kauzë në kushte shumë të vështira, kur vëmendja për shkollat profesionale thuajse nuk ka ekzistuar. Në emër të qeverisë shqiptare, dua t'ju them se e vlerësojmë shumë të gjithë kontributin dhe motivimin tuaj.

Shumë faleminderit edhe për kontributin tuaj në një kohë kur jo gjithmonë qeveria shqiptare e ka pasur prioritet arsimin profesional, dhe ndoshta me të drejtë, pasi ka pasur gjëra të tjera më urgjente. Jam shumë i lumtur sot që në emër të qeverisë shqiptare të them se ky është një prioritet i yni dhe në emër të Kryeministrit do të doja që t'i uroja kësaj konference dhe këtij forumi, një ditë të mbarë plot me ide dhe plot me zgjidhje konkrete, se si ne mund ta bëjmë më të mirë dhe më të mbarë projektin për modernizimin e shkollave profesionale.

Sot jemi në prag të një ngjarje të madhe dhe të rëndësishme për Shqipërinë. Marrja e statusit të vendit kandidat! Sigurisht, kjo është një arsye e mirë për t'u gëzuar për arritjet e të gjithë atyre punonjësve të administratës së qeverive të ndryshme dhe atyre që kanë kontribuar në këtë proces, por ndoshta është edhe një çast i mirë për të reflektuar pak dhe për t'i bërë disa pyetje vetes.

Është shumë mirë që jemi më afër Evropës, por çfarë dimë të bëjmë ne? Një nga gjërat që njerëzit pyesin kur u prezantohesh si shqiptar është: Çfarë prodhoni ju? Cila është marka që ju bën të njohur? Jam shumë i lumtur që tetori gjerman është një mënyrë për të reflektuar, jo vetëm mbi Gjermaninë si logo e kombit gjerman dhe si logo e qeverisë gjermane, por si një potpuri, një kolazh logosh edhe brand-esh, që e bëjnë Gjermaninë atë që është sot në farmaceutikë, në teknologji, në pajisjet sportive, në gastronomi. Unë besoj se sot është një moment për të reflektuar se çfarë e bën Gjermaninë të suksesshme; çfarë i bën këto logo të suksesshme; çfarë e bën historinë e tyre të suksesshme dhe si mundet që ne të kopjojmë dhe të arrijmë të kemi një mimikë të asaj që e ka bërë sot Gjermaninë të suksesshme?

Unë besoj se zgjidhjen e kemi këtu dhe ajo u përmend edhe nga folësit e tjerë: Arsimi profesional! T'u mësojmë njerëzve të bëjnë diçka dhe jo vetëm të lexojnë ose të mendojnë gjëra. Ndaj edhe jemi të përkushtuar që në buxhetin e ardhshëm të reflektojmë më shumë shpenzime për arsimin profesional. Është e vërtetë se nuk mund ta rrisim dot "byrekun" e financave të shtetit shqiptar, por sigurisht që mund ta ndajmë ndryshe atë, sidomos sa i takon arsimin profesional. Përveç përshëndetjes dhe urimit për sukses, do të doja që edhe të provokoja me disa pyetje të cilat mund të nxisin disa ide dhe diskutime.

Ne po përjetojmë një krizë të remitancave. Krahu ynë i punës, i cili dërgonte remitanca në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit,

kryesisht nga Greqia, Italia dhe Gjermania, sa vjen dhe po tkurret. Kjo është e dukshme në vendet që po kalojnë krizë dhe pagesat që po vijnë në Shqipëri janë edhe më të pakta. Vendet që nuk po kalojnë krizë si Gjermania apo vende të tjera, emigrantët shqiptarë të cilët para 23 vjetësh ishin në të 20-tat e tyre, sot kanë kapur të 40-tat, kanë fëmijët e tyre për të rritur dhe dërgojnë gjithmonë e më pak para në Shqipëri. Për të gjitha këto arsye, ne sot kemi një deficit në buxhetin tonë dhe në buxhetin e familjeve tona, që duhet kompensuar duke prodhuar "Made in Albania", ose duke mësuar forcën e re punëtore që të prodhojë, të shpikë dhe të jetë sipërmarrëse për të shtuar dhe kompensuar këto të ardhura.

Një ide tjetër është se si të zgjidhim dilemën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ne nuk mund të kemi 800 vetë që punojnë për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, të cilët gjatë një viti u gjejnë punë 700 vetëve. Në tregun e lirë kjo do të ishte një kompani e falimentuar. Ne na duhen mënyra për të modernizuar shërbimin tonë kombëtar të punës, në mënyrë njerëziteti e talentuar e me dhunti, të aftë për tregun e punës, të lidhen me kompani që kanë nevojë për këtë lloj të krahut të punës. Kjo është arsyeja pse ne po partnerizohemi me agjencinë gjermane të punësimit, për të qenë inovatorë në mënyrën se si lidhim kërkesën dhe ofertën në tregun e punës.

Provokimi i tretë që doja t'i bëja këtij forumi është, se si mund të modernizojmë dhe depolitizojmë shkollat tona? Si mund të japim një rol më të madh që të jenë prindërit dhe bordi i shkollës ata që vendosin mbi lidhshmërinë e shkollës, që vendosin për drejtorin, për bonuset e mësuesve të motivuar, për mënyrën se si do të krijohen praktikantët për sistemin dual. Në qoftë se jeni përfaqësues të komunitetit të biznesit, këtë nuk do t'ju kërkoja si favor, por do t'ju sugjeroja që të përfshihen në skemën e pranimit të të rinjve, studentëve dhe nxënësve në skemat e praktikave pranë bizneseve tuaja. E gjithë evidenca botërore sot, jo vetëm në Gjermani, por në të gjitha vendet gjermanike, si Austri apo Zvicër, të cilat janë suksese ekonomike, demonstroi se ato biznese që janë mendje hapur, që kanë një vizion për të pranuar skema të tilla, për të futur burime të reja njerëzore si praktikantë apo çirakë, janë historitë e suksesit në biznes.

Unë e kuptoj se Shqipëria është një vend i vështirë për të qenë një sipërmarrës i suksesshëm, por qeveria e re me format që po paraqet do t'ua bëjë më të lehtë dhimbjen e kokës dhe do të lehtësojë të bërit biznes në Shqipëri. Ju garantoj se nëse ka një histori suksesi të biznesit, është ajo e hapjes ndaj këtyre ideve të reja. Do t'ju kërkoja për të mirën tuaj, por edhe për të mirën e kësaj kauze, që të konsideroni ta hapni biznesin tuaj ndaj ideve për praktikantët dhe çirakët që ne duam të realizojmë në bashkëpunim me shkollat profesionale.

Edhe njëherë ju uroj shumë sukses dhe ju faleminderit për kohën, atë copë të jetës suaj që i dedikuat këtij forumi dhe kësaj kauze.

## Adresim i prioriteteve, Zhvillimi Ekonomik

Arben Ahmetaj

Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes



Ju falenderoj për mundësinë që më jepni për të shkëmbyer me ju ide, mendime apo edhe iniciativa që kanë të bëjnë pikërisht me temën që po diskutojmë në këtë konferencë. Terminologjia e përdorur është e duhura; zhvillim ekonomik, arsim profesional, mirëqënie. Tog-fjalëshat sëbashku, kanë thelbin e zhvillimit ekonomik, por rrezikojnë të mbeten retorike, për shkak se akoma në Shqipëri, nuk kemi bërë një përpjekje të integruar për të kaluar nga zhvillimi i natyrshëm ekonomik, në zhvillimin e integruar ekonomik, në zhvillimin e zgjuar ekonomik, në zhvillimin afatgjatë ekonomik.

Një vend si Shqipëria që është një treg i vogël, i cila ka vetëm 3 milionë konsumatorë në rastin e vet më të mirë, fatkeqësisht ende konsumatorë të klasës së mesme apo të pasur, por me një shtresë në nevojë shumë të madhe, sigurisht, nuk është një vend tërheqës për investimet e huaja. Këtu dua të theksoj një element tejet të rëndësishëm për të cilin jam i bindur se të gjithë ju e ndjeni, e ndani me njëri-tjetrin dhe e besoni tashmë;

Shqipëria realisht e ka konsumuar mundësinë e zhvillimit nëpërmjet borxhit. Nivelet e borxhit ju i dëgjoni, i ndjeni dhe e kuptoni që janë alarmante. Shqipëria e ka humbur atë “flow” (rrjedhë) të parasë që vinte nga emigrantët, sepse shumica e njerëzve, e vëllezërve, e motrave, miqve tanë, janë stabilizuar në emigracion dhe prurjet janë gjithmonë e më të vogla. Dyzetë përqind më të vogla se në momentet fillestare. Gjithashtu kemi një ekonomi, ku krahu i eksportit është akoma tejet i dobët dhe rezervat natyrore, ato që janë sërisht në standartet ndërkombëtare, janë të vogla.

Atëherë, si mund të zhvillohet Shqipëria?

Dua t’ju sjell një moment nga një nga librat më të mirë për mendimin tim; “Why Nations Fail?”, përse bien kombet, përse dështojnë kombet? Konkluzioni i atij libri është fare i thjeshtë. Sjell shembuj sesi kombe të tëra, shtete të tëra të pasura pa fund me pasuri natyrore kanë dështuar, dhe se si kombe, shtete të cilat nuk kanë pasur asgjë, sot lulëzojnë. Kjo ka vetëm një arsye, Potenciali Njerëzor /Human Capacity. Dhe në fakt, po ta shikoni, në qendër të zhvillimit ekonomik dhe mirëqënies është arsimi profesional. Personalisht, besoj jashtëzakonisht shumë tek arsimi profesional.

Kisha ndërmend të mbaja një fjalë tradicionale të një ministri të zhvillimit ekonomik, ku të flisja për çfarë ka ndodhur në Shqipëri, çfarë po ndodh sot dhe çfarë synimesh ka qeveria, por vendosa të dal jashtë kësaj, për të ndarë me ju një eksperiencë të fundit që pata vetë në universitetin e Harvardit. Sëbashku me Erionin, në debatin që bëmë atje për të parë se cilët sektorë do të ishin më interesantët për investimet e huaja, na u prezantua një qark shumë interesant mbi çka ndodh sot me sektorët në Shqipëri, duke filluar që nga tekstilet që ishin tek baza dhe duke vazhduar me makineritë, me industrinë, deri tek teknologjia e lartë. Boshllëku midis gjithë sektorëve ishte pikërisht ajo që akoma na mungon, “human capacity” dhe sot është momenti që të lëmë mbrapa të gjithë atë zhvillim të natyrshëm dhe rastësor që merr kapaciteti njerëzor, të mendojmë shumë thellë dhe shumë të strukturuar se çfarë do të bëjmë me të. Përse e

them këtë?

Mbi 50 përqind, e të rinjve janë të papunë. Cila është arsyeja? Dikush thotë zhvillimi ekonomik, dikush thotë sektorët e pazhvilluar, dikush thotë sektorët e falimentuar, dikush thotë “rule of law”. Sigurisht që janë të gjitha bashkë, por ka një element të rëndësishëm; ne nuk mund ti ofrojmë investitorëve të huaj aftësi profesionale.

Nuk i kemi dhe këtë duhet ta pranojmë. Jo të gjithë do të behemi juristë, avokatë, shkencëtarë, por arsimi profesional për ekonominë Shqiptare, do të jetë leva e Arkimedit, që të bëhemi interesant për investimet e huaja duke bërë që Shqipëria të bëhet një treg me rajonin.

Pra nga 3 milion, në 20 milion. Në qoftë se Shqipëria i bën realisht kufijtë e vet non-ekzistent, në aspektin e kapitalit, të lëvizjes së mallrave dhe të fuqisë punëtore, vetëm atëherë ajo mund të shfrytëzojë pozicionin e vet gjeografik. Por cili është shtrati që të gjitha këto që themi të zhvillohen? Është kapaciteti njerëzor të cilin ne nuk e kemi akoma dhe unë them se e mira fillon nga pranimi i së keqes.

Këtu dua të theksoj, se politika ekonomike e qeverisë Rama është e qartë edhe në këtë aspekt. Siç tha edhe ministri Veliaj, fokusi i arsimit nuk është thjesht që të plotësojmë raportet e Bolonjës. Thelbi është se çfarë nxjerrim nga shkolla? Dhe në qoftë se nga shkolla nxjerrim njerëz që e shikojnë shtetin si shpëtimin dhe jo privatën si shpëtimin e ekonomisë dhe shpëtimin e shtetit, atëherë kemi dështuar.

Mund të jemi krenarë sot që kemi 80 apo 40 universitete, që të gjithë shqiptarët shkruajnë dhe flasin shqip? Mund të jemi krenarë që kemi një fuqi punëtore e cila sa del nga bankat e shkollës është e sigurtë që nuk gjen punë e që përplasen në dyert e shtetit, në dyert e ministrive, si të qeverisë së kaluar ashtu edhe të kësaj qeverie për punë? Ky është momenti ku mendohet strategjikisht edhe politika e qeverisë Rama. Politika e qeverisë sonë për arsimin profesional është e thellë, e vërtetë dhe është shkëputja e parë nga retorika për një zhvillim ekonomik të bazuar në kapacitetet njerëzore.

E mbyll duke u kthyer sërisht në fillës të fjalës time; Një shtet, një komb nuk bëhet i pasur nëse ka naftë, nëse ka det, nëse ka krom. Bëhet i pasur nëse njerëzit e tij bëhen një enciklopedi dije dhe zgjidhjesh. Kapaciteti njerëzor e shpëton dhe e zhvillon vendin e vet. Dhe besoj e arsimit i mirë profesional dhe shembulli Gjerman për arsimin profesional mund të jetë një fillim i mirë për arsimin profesional shqiptar.

## “Të bëhemi konkurrues me aftësi, shprehi dhe produktivitet”

Gentjana Sula

Zv. Ministre e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë



Shoqëria shqiptare përjeton sfida të mëdha. Tranzicioni ynë, ndryshe nga proceset e ngjashme në vendet e tjera, ka qenë dhe vazhdon të jetë më i zgjatur në kohë, më i vështirë në problematika dhe me kosto më të lartë. Duke u ndalur te kjo e fundit, dëshiroj të nënvizoj se mjaft burime financiare, njerëzore dhe institucionale të vendit nuk i janë kthyer shoqërisë sonë mjaftueshmërisht me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës.

Midis tyre dëshiroj të nënvizoj një zhvillim të pamjaftueshëm të pasurisë ndoshta më të madhe që ka Shqipëria: kapitalin njerëzor. Ky kapital duhet mbështetur dhe një nga format është dhe formimi e trajnimi profesional. Prandaj pjesëmarrja në këtë konferencë është kënaqësi, por është në të njëjtën kohë edhe një detyrim dhe përgjegjësi e madhe. Bashkëpunimi ynë duhet të na shtyjë drejt reflektimesh dhe analizash serioze profesionale, institucionale, politike dhe kombëtare. Punësimi dhe aftësitë nuk janë thjesht një problem ekonomik apo shoqëror. Unë do t'i vlerësoja si një çështje kyç në zhvillimin kombëtar, ndoshta ndër problemet dhe sfidat më madhore të vendit dhe të qeverisjes.

Shoqëria shqiptare sot ndodhet përballë sfidash të mëdha. Papunësia e të rinjve ka arritur pikën kritike. Kemi mbi 30 për qind të punëkërkuessve të regjistruar që janë të rinj. Ky numër është shumë më i madh, pasi në vendin tonë kultura e regjistrimit në zyrat e punës është e mangët. Gratë dhe vajzat janë më shumë të punësuar në biznese familjare ose janë shtëpiake. Për pasojë, produktiviteti i tyre është i ulët dhe të ardhurat janë më pak se modeste ose krejtësisht të papaguara. Edhe ato gra dhe vajza, të cilat janë punësuar me kohë të plotë, kanë pagesa të padrejta në raport me cilësinë e punës së tyre. Diferenca në paga është një ndër çështjet më problematike në tregun dhe në botën shqiptare të punës. Kësaj situatë i shtohen dhe numri gjithnjë e në rritje i personave që trajtohen me pagesa papunësie, me ndihmë ekonomike apo pagesa lidhur me aftësinë e kufizuar. Të gjithë këto grupe lihen të pa trajtuar me shërbime formimi profesional dhe punësim. Paaftësia relative, papunësia e zgjatur, varfëria dhe varësia e tyre, mbeten afatgjatë dhe rrezikojnë të riprodhohen kështu në mënyrë ciklike.

Vizioni i qeverisë së re, dhe veçanërisht i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, kërkon të ndërtojë një model të ri zhvillimor, ku rritja ekonomike është në funksion të qytetarit. Ndaj dhe zotimi i qeverisë në program është krijimi i 300 mijë vendeve të reja të punës.

Po ku do të gjenerohen këto vende pune?

Së pari, në ekonominë prodhuese. Jo vetëm për krenarinë e të bërit produkte “Made in Albania”, por shtimi i prodhimit dhe i produkteve të vendit sjell si rezultat edhe vende të reja pune, që mundësojnë jetesë më të mirë për qytetarët. Në këtë rrugë synohet të hapen rreth 40 mijë vende pune. Rreth 15 mijë vende të tjera janë të lidhura me industrinë nxjerrëse, transportuese apo përpunuese të detit. Më pas vjen bujqësia, blegtoria dhe agropëpunimi, me një potencial prej rreth 155 mijë vendesh pune. Siç dihet, ka një pabarazi në ofrimin e shërbimeve të arsimit dhe formimit profesional mes qytetit dhe fshatit. Popullsia e fshatit konsiderohet e gjitha e vetëpunësuar. Arsimit profesional në fshat është pothuajse inekzistent, sikurse dhe shërbimet e punësimin,

ndërkohë qëkjo popullsi konsiderohet si një ndër gjeneratorët e ekonomisë me një potencial të madh akoma të pashfrytëzuar. Të ashtëquajturit fermerë shqiptarë, përveç nevojave të ngutshme kërkojnë gjithashtuformim profesional e njohuri teknologjike sa më të reja në fushën e kultivimit të produkteve, si dhe përpunimit të tregtimit të tyre.

Qeveria e re ka vendosur që shërbimet e arsimit dhe formimit profesional të jenë ngushtësisht të lidhura me ato të punësimin. Qëllimi është që t'u japim mundësi punëkërkuessve të formohen profesionalisht dhe këto njohuri t'ju shërbejnë për t'u punësuar. Formimi profesional duhet të konsiderohet rruga më efikase e rritjes së punësueshmërisë dhe produktivitetit të fuqisë punëtore. Sot në tregjet botërore nuk konkurrohet më me kosto të ulët pune, por me shprehi të larta profesionale. Ato rrisin cilësinë dhe sasinë e produkteve, ulin kostot dhe e bëjnë ekonominë dhe fuqinë punëtore konkurruese në tregjet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne jemi shumë larg këtij realiteti dhe programi i qeverisë synon ta arrijë këtë objektiv.

Punësimi i të rinjve mbetet një problem prioritar kombëtar. Banka Botërore boton një raport për zhvillimin e botës në çdo vit. Raporti i vitit 2013 lidhej me punësimin. Nga studimi i kryer u gjet se punësimi i të rinjve mund të përmirësohej vetëm nëse shërbimet e punësimin shoqëroheshin me rritje të aksesit në arsim dhe formim profesional. Ky efekt ishte edhe më pozitiv kryesisht tek punësimi i vajzave dhe grave. Një ndër gjetjet e tjera të studimit është dhe lidhja e domosdoshme që duhet të kenë shërbimet e formimit me të punësimin. Shërbimet e punësimin fillojnë që nga këshillimi, orientimi në treg, mbështetja për një kohë të caktuar për praktika në vendin e punës, por edhe mbështetja me grante të vogla si kapital për ato të cilët tregojnë aftësi sipërmarrëse. Për këto arsye, ne synojmë në zhvillimin e sistemit dual si një ndër format më të suksesshme të arsimit dhe formimit profesional, si dhe shërbime punësimi dhe formimi të integruara. Në këtë vazhdë, një ndër programet që MMSR përgatit, është edhe nxitja e programeve rinore të “çirakërisë”. Bëhet fjalë për ata të rinj e të reja që kryejnë praktikën dhe zhvillojnë aftësi në vendin punës, shoqëruar me program akademik nëpërmjet shkollave profesionale.

Për të përballuar tërë këto sfida, kemi nisur një proces të gjerë konsultimi dhe kemi ngritur grupe pune të përbashkëta me ministrinë e Arsimit, Financës, Ekonomisë, Shërbimit Kombëtar të Punësimin, Agjencinë e Formimit Profesional dhe donatorë të huaj. Të gjithë po punojmë për të realizuar një reformë ligjore sa më të mirë, reformë administrative, atë të financimit të arsimit dhe formimit profesional, si dhe ri-konceptimin e ofruesit publik të formimit të aftësive.

Dëshiroj gjithashtu të shpreh vlerësimin maksimal për kontributin e dhënë nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë, për përmirësimin e shkollimit dhe formimit profesional në vendin tonë. Një falënderim i veçantë u takon të gjithë donatorëve, por veçanërisht popullit gjerman për mbështetjen e vazhdueshme në rritjen e punësimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve shqiptarë, në replikimin e një sistemi të formimit të aftësive që është ndër më të suksesshmit sot në botë.

## “Unë kam një ëndërr - Vizioni im për të ardhmen e Shqipërisë”

Diana Çuli

Shkrimtare



Sot, pas 22 vjetësh ne kemi arritur të sigurojmë barazinë ligjore – me një legjislacion modern, evropian. Kemi përmbushur disa sfida në mënyrë të habitshme, për shembull: kemi gjysmën e qeverisë shqiptare të drejtohet nga gratë, i kemi ato në poste të larta vendimmarrëse të një rëndësie të veçantë dhe ky është një realitet që nuk ka ndodhur asnjëherë më parë në historinë e shtetit shqiptar. Kjo është shenjë e fuqishme emancipimi shoqëror, por edhe vizionar. Prania e një numri të madh grash do të ndikojë në një sjellje parlamentare dhe ekzekutive, më pak konfliktuale e më pak të dhunshme. Opinione, mendimet, qëndrimet e grave, që janë të ndryshme nga ato të burrave, do të krijojnë një atmosferë më konstruktive për shoqërinë në procesin e ligjvënies.

Ne e dimë se demokracia zgjerohet dhe funksionon kur qytetarët janë pjesëmarrës në të. Në një rend politik, ku të interesuar janë vetëm aktorët e drejtpërdrejtë politikë, vetëm ata të lidhur me partitë ose vetëm me drejtimin e saj, nuk mund të quhet më i tillë. Por, nga ana tjetër ka gjithnjë një interes personal, i cili është pazgjydhshmërisht i lidhur me interesin e përgjithshëm. Cili është interesi im personal? Të jetoj në një vend ku të gjithë të jemi të barabartë para ligjit, ku ky ligj të funksionojë, ku brezat e rinj të sotëm dhe brezat pas tyre të mundin të ndërtojnë një të ardhme evropiane. Që do të thotë të jesh i lirë në mendjen tënde, në veprimtarinë e tua dhe të jesh gjithashtu një qytetar i përgjegjshëm, që të zbatosh rregullat dhe ligjet që ke votuar vetë. Ky është interesi personal, që nuk do të realizohet kurrë nëse ne nuk jemi të vëmendshëm se çfarë po ndodh me politikën shqiptare, nëse nuk votojmë për bindjet tona dhe nëse nuk mbajmë qëndrime qytetare edhe në mikrobotën tonë të vogël.

Politika demokratike nuk ndërtohet mbi aksioma, por mbi diskutimin. Është si rërë e lëvizshme. Në këtë etapë të re tonë të ndërtimit të demokracisë, e kemi të qartë se ky sistem është shumë më i ndërlikuar dhe më i sofistikuar se sa ai që ishim mësuar në gjithë historinë tonë të autoritarizmit, ku gjithçka ishte bardh e zi. Demokracia po na bën të qartë se nuk ka asgjë të përsosur fund e krye, veçanërisht në marrëdhëniet politike, por ka rrugë të vështira. Kërkohej vendosmëri, po edhe tolerancë, qëndrim i prerë, po edhe kompromis, hedhje dorashke, po edhe negociatë. Për të arritur qëllimin final, realizimin e një programi ripërtëritës, duhen shumë faktorë, edhe kur me disa prej tyre nuk jemi krejtësisht dakord. Historia e Bashkimit Evropian, ku duam të hyjmë, është histori kompromisi dhe negociatë dhe jo histori konflikti e barrikade.

Ekziston pyetja: pse shqiptarët dëshirojnë pa dyzime hyrjen në Evropë? Për të qenë pjesë e Evropës së Bashkuar, këtij projekti - në krye, kur lindi, i pabesueshëm e utopik, por sot pas dekadash një realitet i fuqishëm paqeje, zhvillimi dhe stabiliteti. Por, siç e thoshte dikur Shumani, më 1950, – një nga etërit themelues evropianë “asgjë nuk arrihet në një ditë dhe asgjë që zgjat nuk bëhet shpejt.” Dhe, siç ata e menduan, ky revolucion i madh, ky vizion i madh, i sofistikuar e i qytetëruar nuk mund të arrihej nga një vullnet i vetëm, por hap pas hapi, duke ndjekur

evoluimin e shpirtit, të solidaritetit, idenë se bashkimi i Europës do të arrihej duke kombinuar suksesin ekonomik me evoluimin intelektual.

Unë mendoj se edhe Shqipëria mund të ndjekë e sigurt këtë projekt evropian. Shoqëria shqiptare hodhi pas, me vendosmëri, gjithçka që e pengonte të ndërmerre e sigurt këtë rrugë lirie dhe solidariteti evropian. Shoqëria shqiptare sapo ka hyrë në një hapësirë të re mendore dhe ripërtëritëse e cila mundëson zhvillimin e qëndrueshëm. Mundëson ridimensionimin e pasurive natyrore, kulturore dhe ekonomike, të të gjitha llojeve, energjinë njerëzore, iniciuese, pozitivitetin dhe flakjen tej të fatalizmit tonë se asgjë nuk mund të ndryshohet.

Unë mendoj se ëndërrat nuk janë gjë tjetër veçse realitete më të mira nga ato që nuk ke patur. Pra mund të mos quhen më të tilla.

Ëndërra ime, dëshira ime, vizioni im është ta ndiej thellësisht se Shqipëria po ecën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të pakthyeshëm pas. Dhe nuk më duket më as ëndërr, as vizion. Tani, më duket e realizueshme.

## Paneli: Shërbimet / Tregëtia

### Prezantimi



Prezantimi i parë i zotit Arian Gjorga, drejtorit ekzekutiv të kompanisë “Megatek” pasqyroi profilin e kësaj kompanie dhe shërbimet që ajo ofron në treg. “Megatek” punëson kryesisht të rinj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional teknik. Rreth 37,5% e të gjithë personelit vjen nga shkollat e mesme teknike profesionale. Përveç kësaj, kjo kompani zbaton projekte të posaçme në mbështetje të arsimit të mesëm profesional në Shqipëri, siç është për shembull trajnimi i mësuesve, organizimi i aktiviteteve informuese për nxënësit, për t’i njohur ata me tendencat më të fundit të zhvillimeve teknologjike. “Megatek” organizon gjithashtu olimpiadën e aftësive, ku marrin pjesë nxënës të shkollave të mesme profesionale nga i gjithë vendi.

“Megatek” i mbështet dhe organizon të tilla aktivitete, jo vetëm që e sheh veten si aktor ekonomik me përgjegjësi sociale, por edhe ngaqë pikërisht nxënësit e arsimit profesional do të jenë punonjësit e saj të ardhshëm. Për këtë kompani, personeli i kualifikuar është çelësi i suksesit në treg.

Megjithatë zoti Gjorga nënvizoi se sistemi arsimor ofron shumë pak në drejtim të formimit praktik. Zhvillimet e fundit të teknologjisë pasqyrohen vetëm pjesërisht në kurrikula. Ai propozoi se sistemi arsimor duhet të qëndrojë në kontakt të vazhdueshëm me tregun e punës, në mënyrë që edhe pritshmëritë e të rinjve, të cilët më vonë do të punësohen, të jenë sa më afër realitetit të botës së punës. Ndërsa kompanitë e biznesit duhet të bëhen de facto pjesë e bordeve të shkollave profesionale.

### Komenti

Me mirëkuptimin e pjesëmarrësve në sallë dhe duke qenë se përfaqësuesit e kompanive të biznesit do të prezantonin dy perspektiva komplementare, në vend të komentit u mbajt edhe një referat i dytë rreth situatës dhe sfidave, me të cilat përballlet industria e turizmit si një faktor kyç i rritjes ekonomike.

Kontributi i këtij sektor në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) llogaritet aktualisht në 22% të tij. Me këtë përqindje në PBB, Shqipëria renditet e treta në Evropë për peshën specifike të sektorit të turizmit.

Për më tepër është një sektor, zhvillimi i të cilit varet veçanërisht nga administrata publike, e cila ka infrastrukturë të dobët, cilesoi Z.Zak Topuzi, pronar i një hoteli të njohur në Tiranë dhe njëkohësisht anëtar i Shoqatës Shqiptare të Turizmit (ATA) të themeluar në vitin 2008.

Ndërkaq vetë kompanive turistike u mungon kultura e menaxhimit. Në shumicën e rasteve detyra e menaxherit ushtrohet nga vetë pronari. Këto kompani e kufizojnë aktivitetin e tyre në tregun vendas dhe rajonal dhe nuk janë në gjendje t’i përgjigjen tregut ndërkombëtar dhe kërkesave të tij.

Një aspekt tjetër negativ është mungesa e koordinimit të ofertës arsimore, sidomos në arsimin terciar.

Bizneset mikro dhe të vogla e kanë të pamundur të investojnë në kualifikimin e personelit, ndërsa nga sistemi nuk mund të garantohet cilësi në arsimin dhe formimin profesional të punonjësve.

Por as vetë klientët nuk presin cilësi shërbimi, çka nuk krijon incentiva për përmirësimin e cilësisë. Por nëse këto biznese duan të jenë atraktive në tregun ndërkombëtar, duhen bërë përpjekje të mëdha pikërisht në këtë drejtim. Ndaj sektori i turizmit e sheh si domosdoshmëri standardizimin e shërbimeve dhe ngritjen e një sistemi certifikimi.

## Diskutimi

Komenti i zonjës Flutura Vaqarri, nga shkolla Hoteleri-Turizëm në Tiranë dhe të tjera komente nga pjesëmarrësit rikonfirmuan sfidat e prezantuara dhe u fokusuan në domosdoshmërinë e cilësisë së kualifikimeve dhe diplomave. Përmirësimi i cilësisë së arsimit profesional mund të arrihet nëpërmjet nismave të qëllimta për kualifikimin dhe trajnimin e mësuesve të arsimit profesional, nëpërmjet skemave më atraktive të pagave për mësuesit specialistë dhe nëpërmjet një bashkëpunimi aktiv ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe privatë. Të dy përfaqësuesit e biznesit dhe drejtuesja e shkollës ishin të një mendjeje se zhvillimi ekonomik dhe arsimit profesional, në përgjithësi dhe në sektorin e shërbimeve në veçanti, janë në varësi të ndërsjellë nga njëri-tjetri.

Të gjithë pjesëmarrësit në panel nënvizuan se kompanitë në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve janë një sektor i rëndësishëm në rritje. Ndaj të dy kompanitë falënderuan edhe një herë për ftesën dhe mundësinë e prezantimit të situatës në këta dy sektorë të rëndësishëm.

### Gjetjet kryesore

- Turizmi, me 22% të PBB, është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomikë në Shqipëri.
- Përfaqësuesit e biznesit duhet të angazhohen në menaxhimin e ofruesve të arsimit profesional.
- Institucionet qeveritare përgjegjëse duhet të investojnë në përgatitjen e mësuesve të arsimit profesional.
- Mësuesit në arsimin profesional duhet të shpërblehen me paga atraktive. Përveç kësaj ata duhet të mbështeten me trajnime të vazhdueshme.
- Duhet të ketë një shpërndarje të racionalizuar në të gjithë vendin të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional.
- Kompanitë e biznesit duhet të ofrojnë më tepër praktika profesionale.
- Zhvillimi afatgjatë i arsimit profesional nuk mund të varet nga donatorët e huaj, por duhet të mbahet në sajë të një strategjie të planifikuar mirë nga qeveria shqiptare.
- Arsimit profesional duhet të ofrojë kualifikim dhe diploma të njohura edhe ndërkombëtarisht.
- Kurrikulat duhet të hartohen në bashkëpunim ndërmjet ekspertëve nga sektori i biznesit dhe ai i arsimit.

## Paneli: Agrobiznes/ Teknologji Ushqimore

### Prezantimi



Gjatë prezantimit, Aida Nani, eksperte e teknologjisë ushqimore dhe Piro Rapushaj, nga Albanian Agriculture Competitiveness Association, tërhoqën vëmendjen fillimisht se bujqësia realizon rreth 17% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) në Shqipëri. Ky fakt nënkupton rëndësinë kyçe të këtij sektori në ekonominë e vendit. Megjithatë ky sektor, ndoshta edhe më tepër se sektorë të tjerë, karakterizohet nga një fragmentim i fortë. Pjesa më e madhe e bizneseve në bujqësi janë biznese familjare.

Njohuritë rreth strategjive të qeverisë apo të BE-së në lidhje me politikat agrare janë qartazi të pamjaftueshme. Në panel u shtrua për diskutim çështja e reduktimit të kësaj mungese të informimit, ndërsa sfidat mbeten ende të mëdha. Oferta e arsimit dhe formimit profesional, njësoj si njohuritë e munguara rreth politikave agrare, është tejet e kufizuar. Ndërsa edhe interesi për arsimin bujqësor është i ulët. Në BE punohet për direktivat e zhvillimit të agrobiznesit, ndaj edhe përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e ekonomisë agrare duhet të mbështeten në këto direktiva. Në këtë mënyrë, Shqipëria mund të shndërrohet në një eksportues të rëndësishëm rajonal të disa produkteve a linjave të produkteve.

### Koment

Në komentin e tij rrethprezantimit, Ilir Mehmeti nënvizoi nevojën, ose më saktë, problemin që sipërmarrësit në bizneset bujqësore duhet të mbajnë disa funksione njëkohësisht. Kështu, në bizneset mikro ose të vogla, ata duhet të jenë njëkohësisht menaxherë, ekspertë shitjesh dhe kontabilistë. Përveç kësaj sipërmarrësit në sektorin e përpunimit ushqimor ankohen se kualifikimet dhe kompetencat në vitetet e fundit kanë rënë. Kësaj i shtohet edhe fakti që në këtë fushë mungon qëndrueshmëria, pasi brezi i ri e shmang sektorin e bujqësisë, d.m.th migron drejt zonave urbane dhe e braktis plotësisht fshatin. Pra nuk ka as kërkesë dhe as ofertë të mjaftueshme për trajnime dhe kualifikim të specializuar në këta dy sektorë. Gjithashtu duhet menduar për format e përshtatshme se si mund të organizohet një bashkëpunim efektiv i aktorëve. Bëhet fjalë, si për një bashkëpunim të prodhuesve ndërmjet njëri-tjetrit, ashtu edhe për infrastrukturën e përmirësuar midis prodhimit dhe përpunimit

### Diskutim

Në diskutimin e gjallë, pjesëmarrësit u thelluanë pyetjen“si” të zhvillohen kualifikimet në fushën e bujqësisë dhe atë të përpunimit ushqimor. Krijimi i një oferte të mjaftueshme është i vështirë, sidomos kur ky sektor është tejetifragmentuar dhe bizneset janë të shpërndara. Në këtë situatë duhet menduar si të krijohen mundësi të reja kualifikimi. Gjithashtu duhen marrë masat e duhura për rritjen e interesit të rinjve për këtë sektor.

Në lidhje me këtë duhet menduar, nëse mund të ketë në të ardhme certifikime ose standarde cilësie për ndërmarrjet e veçanta. Kjo mund të vlejë më pas edhe për produktet. Në lidhje me këtë u diskutua, nëse për këtë arsye të zhvillohet një regjistrim shtetëror i të gjitha bizneseve familjare.

Të gjitha masat për përmirësimin dhe efektivizimin e sektorit kërkojnë gjithashtu një trajnim në procese të ndryshme, nga prodhimi deri te përpunimi. Gjithashtu ekziston nevoja e përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme, si p.sh. furnizimi me ujë, furnizimi me energji elektrike apo përmirësimi i rrjetit të transportit. Në përgjithësi sektori i agrobiznesit është lënë mënjanë me problemet e veta të zhvillimit, sepse me sa duket deri tani nuk ka pasur lobim të fortë. Ky sektor mbahet nga biznese të vogla familjare, të veçuara, të cilat në të shumtën e rasteve prodhojnë mjaftueshëm vetëm për nevojat e tyre, ndërkohë që ekzistojnë mundësi shumë herë më të mëdha të përfitimeve nga ky sektor.

## Gjetjet kryesore

- Njohuritë rreth prodhimit bujqësor modern mungojnë gjerësisht. Për këtë arsye duhen zhvilluar modele specifike dhe të qarta për përmirësimin e fitimit dhe të cilësisë së produkteve dhe të proceseve të përpunimit.
- Duhet ofruar trajnime të shkurtra të qëllimta në forma dhe mënyra që u japin mundësioperatorëve të sektorit të agrobiznesit, duke marrë në konsideratë orarin dhe ngarkesën e punës.
- Cilësia e deritanishme e prodhimit i nënshtrohet një kontrolli të pamjaftueshëm. Për këtë arsye duhet vendosur si qëllim, të certifikohet si kualifikimi i operatorëve, ashtu edhe cilësia e përpunimit të produkteve.
- Në të ardhmen, cilësia e produkteve të sektorit bujqësor do të luajë një rol akoma më të rëndësishëm. Për zhvillimin e përmbajtjes dhe kërkesave të certifikimit dhe zbatimit të tyre duhet ngritur një komision i pavarur, i cili të jetë i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme. Në këtë mënyrë mund të vendosen në të gjithë vendin standarde të cilësisë.
- Deri tani ekziston vetëm një pasqyrë e pamjaftueshme e bizneseve prodhuese dhe sipërmarrësve të vegjël. Për këtë arsye duhet të regjistrohen nga shteti të gjitha bizneset bujqësore. Kjo vlen edhe për bizneset e vogla familjare, domethënë, të atyre që prodhojnë vetëm për konsum familjar.
- Kuadri ligjor aktual ka nevojë për detajim për zgjidhjen dhe strukturimin e problemeve të ndërthuruara dhe orientimin drejt kërkesave të modernizimit.
- Shumica e bizneseve individuale nuk shikojnë mundësitë për aplikimin e mjeteve financiare në arsimimin dhe trajnimin e tyre. Për këtë arsye duhet krijuar një fond i posaçëm, prej të cilit të financohet arsimimi. Kjo vlen edhe për trajnimet dhe praktikatat.
- Institutet arsimore shqiptare nuk e mbështesin zhvillimin e sektorit të bujqësisë me oferta të një arsimimi modern. Studentëve të interesuar duhet t'u ofrohen bursa për të sjellë në vend përvoja dhe dije të reja. Investime të tilla janë afatgjata dhe me vlerë, sepse në këtë mënyrë ky sektor rrit konkurrueshmërinë e tij.
- Deri tani sektori i agrobiznesit përballet me mungesën e interesit nga të rinjtë. Arsyet e kësaj mungese interesi janë edhe teknologjitë e vjetra të prodhimit dhe fitimet e ulëta. shijon vetëm një interesim të vogël të të rinjëve. Kjo për shkak të teknologjive të vjetra të prodhimit dhe të fitimeve të vogla që rrjedhin prej saj. Për këtë arsye krahas përmirësimeve duhet krijuar një program publik, i cili reklamon sektorin dhe informon në mënyrë të detajuar rreth ofertave të kualifikimit dhe rreth mundësive të zhvillimit të bazuara te kualifikimet.

## Paneli: Prodhim / Industri

### Prezantimet



Në panel, zoti *Ermal Luka* prezantoi nevojën e sektorit për specialistë të kualifikuar nisur nga shembulli i kompanisë së tij Europa MetalConstruction. Kjo kompani inovative në ndërtimin e konstrukteve të çelikut, e cila ka krijuar treg për produktet e veta në shumë vende të BE-së, e bazon suksesin te motivimi dhe kualifikimi i punonjësve të saj. Moshë mesatare e punonjësve të kësaj kompanie është mbi 50 vjeç dhe njësoj si edhe kompani të tjera në këtë sektor është e vështirë të rekrutosh të rinj, të cilët nuk janë arsimuar gjatë periudhës komuniste. Përveç saldatorëve të çertifikuar ka një nevojë të ngutshme për punues metalesh, por edhe për specialistë CNC dhe inxhinierë projektues.

Posaçërisht për tregun evropian me standardet e tij të përkufizuara qartë nevojiten punonjës të mirarsimuar, sidomos në fusha që kërkojnë masa të veçanta sigurie si për shembull në profesionin e saldimit, ku respektimi i standardeve dhe certifikatat ndërkombëtare është domosdoshmëri. Kjo garantohet nëpërmjet kontrolleve të panjoftuara në kompani nga klientët. Kurse të tilla në Shqipëri ofrohen nga WiFi Albania (Instituti Austriak për Nxitjen e Ekonomisë). Arsimi në shkollat profesionale përshkruhet si i pamjaftueshëm nga kompanitë, ndërsa as qendrat e formimit profesional të Ministrisë së Punës nuk ofrojnë programet e duhura.

Zhvillimi i mëtejshëm i një sërë biznesesh në Shqipëri do të varet shumë nëse ato do të rekrutojnë punonjës të mirarsimuar e të motivuar, të cilët, me sa duket, nuk mund të gjenden në shkollat profesionale. Trajnimet në disa teknologji si për shembull teknika CNC, pa të cilën kompanitë nuk mund të jenë konkurreuese në tregun evropian, ende nuk ofrohen në vend. Bashkëpunimi konkret ndërmjet shkollave profesionale dhe kompanive ende nuk është vendosur, edhe pse u shpreh qartë gatishmëria për një gjë të tillë. Sidoqoftë duket se ende nuk ekzistojnë mekanizmat funksionues.

### Komente

Zoti *Bashkim Shkëmbinga* shkolla profesionale Beqir Çela në Durrës, në komentin e tij sqaroi se infrastruktura e nevojshme për një arsimim profesional të përshtatshëm në varësi të profilit (drejtimit) është shumë e shtrenjtë dhe se është e vështirë ta mbash një shkollë profesionale në nivelin aktual të zhvillimit të teknologjisë. Sipas tij, është e rëndësishme që kompanitë të kërkojnë lidhjen me shkollat, në mënyrë që edhe këto të fundit të njihen me shprehinë dhe kompetencat e domosdoshme për të ardhmen. Kjo mund të reflektohet më tej edhe në ofertën arsimore. Duke qenë se shkollat profesionale nuk mund ta ndjekin përparimin e teknologjive, bashkëpunimi me kompanitë shndërrohet në një kusht të rëndësishëm për të ofruar arsimim me cilësi, i cili përgatit të diplomuar, të cilën pranohen nga tregu i punës. Zoti Shkëmbi u shpreh i bindur se një sërë problemesh të arsimit profesional mund të zgjidhen, vetëm nëse përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe shkollave.

Në një koment të dytë nga zonja *Enkeleđa Sojta*, Universiteti Politeknik i Tiranës, u theksua se të rinjtë shpesh zotërojnë dije teorike dhe aspak përvojë praktike ose anasjelltas. Ndaj qëllon të ndeshësh shumë persona, të cilët kanë përvetësuar shkathtësi praktike, kryesisht në Itali dhe në Greqi, por të cilët nuk kanë bazën teorike për të punuar në mënyrë profesionale. Në universitet në vitet e fundit janë bërë disa përpjekje për t'u njohur studentëve përvojat praktike në formën e praktikave profesionale. Por në arsimin profesional mungojnë standarde të certifikuara e të besueshme, çka e bën të vështirë për kompanitë dhe të rinjtë për të kuptuar vlerën e arsimit profesional.

### Diskutim

Në rrjedhën e mëtejshme të diskutimit me publikun, çështja e standardeve zuri një vend të rëndësishëm. U vërejt se informacionet e përcjella në certifikime të ndryshme nuk përputhen me nivelin real të informacionit dhe të dijës, duke mos e bërë më të lehtë për kompanitë, të cilat duan të punësojnë dikë, të vendosin në favor të një aplikanti që ka përfunduar një shkollë profesionale.

U përmend se në sistemin dual, siç ky aplikohet në Gjermani, kostot mund të minimizohen, nëse kompanitë marrin përsipër përgjegjësinë kryesore të formimit praktik, nga ku mund të garantohet edhe përcjellja e teknologjisë më të fundit. Nëpërmjet një shembulli u ilustrua nga një pjesëmarrëse se ka një ndryshim të madh ndërmjet një praktikanti, i cili ka një kontratë me një kompani, që e ndien veten pjesë të kësaj kompanie dhe një nxënësi të një institucioni publik. Këtu duhen parë edhe efektet e drejtpërdrejta në motivimin dhe zhvillimin e personalitetit të të rinjve.

Nga publiku u pasqyrua edhe përvoja e firmave që iu drejtohen gjithmonë kompanive të kurseve kualifikuese dhe që ankohen se në Shqipëri nuk gjenden mjaftueshëm punonjës specialistë. Megjithatë vazhdon dyndja e të rinjve drejt studimeve universitare, edhe pse shanset e punësimit nuk janë të mira. Në shkollat profesionale, plani mësimor përmban shumë lëndë, të cilat janë të domosdoshme për marrjen e provimit të pjekurisë, duke ngushtuar hapësirën për zhvillimin e shprehive dhe kompetencave. Synimi për punësueshmërinë e të rinjve që përfundojnë arsimin profesional nuk mund të realizohet edhe për arsyen se kurrikula nuk orientohet nga nevojat e biznesit. Ndaj i bëhet apel qeverisë shqiptare dhe biznesit të punojnë për një zgjidhje, e cila jo vetëm të çojë përpara ekonominë e vendit, por edhe të krijojë vende pune. Një mënyrë për arritjen e këtij synimi, siç u përmend disa herë në panel, është krijimi i standardeve të akredituara me shpresën se kështu mund të rritet cilësia e kualifikimit dhe të arrihet niveli evropian. Në disa sektorë me rëndësi dhe që kërkojnë masa të larta sigurie, ka procese që në të ardhmen duhet të kryhen vetëm nga persona, të cilët zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura dhe që mund t'i dëshmojnë këto, siç është praktika në vendet e BE-së.

### Gjetjet kryesore

- Punonjësit e mirëkualifikuar në Shqipëri janë shpesh mbi 50 vjeç. Këta punonjës janë arsimuar në sistemin komunist. Më të rinjtë nuk kanë kualifikim të plotë.
- Punonjësit e kualifikuar janë domosdoshmëri për të ruajtur konkurrueshmërinë e produkteveshqiptare në vend dhe për të krijuar mundësinë e eksportimit të tyre jashtë vendit.
- Aftësia për të ofruar produkte të pajisura me certifikata të njohura ndërkombëtarisht (në përputhje me normën ndërkombëtare) është alfa dhe omega për strategji të suksesshme biznesi.
- Kualifikimet nga vetë kompanitë “on the job” nuk mund të zëvendësojnë për shumë kohë arsimin profesional dhe cilësor, por thjesht të zbusin deficitin aktual të kompanisë.
- Një kualifikim profesional duhet t’u përgjigjet standardeve kombëtare dhe të certifikohet në mënyrë të parvarur, me qëllim që të gjitha kompanitë që punësojnë dikë, të kenë garancinë se kualifikimet e kërkuara plotësohen nga aplikantët.
- Kualifikimi profesional cilësor mund të organizohet vetëm në sajë të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet shkollave profesionale dhe biznesit.
- Kualifikimi profesional duhet të jetë atraktiv për të rinjtë. Duhet bërë e qartë se vetëm një kualifikim i mirë mund t’iu sigurojë atyre një të ardhme të sigurt.
- Me fushata të gjera dhe këshillim aktiv të të rinjve dhe prindërve të tyre duhen rrëzuar paragjykimet ndaj arsimimit jo akademik dhe karrierës profesionale.
- Duhet ofruar incentiva nga kompanitë për punonjësit specialistë të mirëkualifikuar, si p.sh. paga dhe shpërblime sipas kualifikimit, por edhe mundësi karriere brenda kompanisë.

## Paneli: Infrastrukturë/Ndërtim/Logjistikë

### Prezantimet



Një nga investimet e huaja më të rëndësishme dhe më të mëdha në Shqipëri ka qenë ai në ndërtimin e aeroportit ndërkombëtar të Tiranës në vlerën 80 milionë euro. Ndërtimi dhe administrimi i aeroportit iu besuan konsorciumit TIA (Tirana International Airport sh.p.k.), kur ky i fundit fitoi tenderin në vitin 2005. Në konsorciumin TIA bënte pjesë koncerni gjerman HOCHTIEF Airport GmbH (47%), Shoqëria Gjermane për Investime dhe Zhvillim sh.a. (DEG) (31.7%) dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Sipërmarrjes (21.3%). Pasi koncerni HOCHTIEF i shiti aksionet e tij në aeroport, ato i kaluan fondit kanadez të pensioneve PSP Investments. *Sonila Rada*, drejtuese e departamentit të burimeve njerëzore e kompanisë përshkruan situatën, me të cilën përballlet TIA në nisje të aktiviteteve të saj në Shqipëri. Këto aktivitete karakterizohen nga specifikat e sektorit të aviacionit, nga domosdoshmëria për të respektuar qysh në krye të herës kuadrin rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar, nga mungesa e personelit të kualifikuar në tregun shqiptar të punës, veçanërisht në këtë sektor. Për më tepër, mundësitë e kualifikimit në Shqipëri për këtë sektor ekzistojnë vetëm pjesërisht.

Qasja e parë e TIA-s ishte kualifikimi i brendshëm i punonjësve në bazë të nevojave konkrete, i cili ofrohej ose në administratën e TIA-s ose jashtë vendit. Rrjedhojë e këtyre masave ishin kostot e larta, ndërprerja e proceseve të punës, mungesa e fleksibilitetit orareve të trajnimit, nevoja për trajnime të mëtejshme. Për t’iu përgjigjur këtyre sfidave, TIA ka zbatuar një program të brendshëm të trajnimit të trajnerëve, që do të thotë se ka rekrutuar trajnerë në tregun shqiptar dhe brenda vetë kompanisë, por aftësitë për përcjelljen e dijes u testuan rast pas rasti.

Një gjë e tillë ka sjellë ulje të kostove dhe fleksibilitet të orareve të trajnimit. Por të metat e kësaj qasjeje lidhen me rrezikun, që trajnerët mund të largohen nga kjo kompani dhe që disa prej tyre nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare.

*Carsten Conrad*, drejtor ekzekutiv i Tirana Business Park (TBP) në vitin 2013 e sheh kompaninë e tij të përballlet me sfida të ngjashme.

Punimet për zbatimin e projektit për ndërtimin e zyrave dhe pasurive të paluajtshme nisën në mesin e vitit 2012. Ky investim prej 100 milionë euro do të jetë edhe investimi më i madh gjerman në Shqipëri. Investitor është **grupi Lindner**, një biznes familjar shumë i suksesshëm me seli në Arnstorf (Bavari), i cili zbaton projekte në mbarë botën në ndërtime interiere, teknika izolimi, shërbime industriale dhe ndërtime fasadash dhe që administron shumë qendra prodhimi në Gjermani dhe jashtë saj.

Tirana-Business Park realizohet nga Lindner Projektentëicklungs GmbH dhe motoja e tij është “we’ll change the way business is done”.

Ky është një aksion për cilësi në Shqipëri, ku ky projekt do të ngrihet në një sipërfaqe 220.00 m<sup>2</sup>, një qytet brenda qytetit dhe pranë aeroportit ndërkombëtar. Është planifikuar ndërtimi i 15 ndërtesave për zyra dhe dy ndërtesave për parkim në një afat dhjetëvjeçar.

Standardet maksimale në ndërtim, siguria, veçanërisht sigurimi i ndërtimit nga tërmetet, të kombinuara këto me një “ambjent të gjelbër” do të jenë dallimi nga ndërtimet e deritanishme për zyra apo mjedise të destinuara në Shqipëri.

Por kjo kërkon standarde të larta kualifikimi të punonjësve zbatues. Për këtë qëllim, TBP ka thelemuar një iniciativë me rrjetin social YUNUS, për t’u ofruar të rinjve, të cilët kanë dëshirë të përvetësojnë një zanat në ndërtim, një qasje praktike. TBP vë në dispozicion hapësira të veçanta për këtë qëllim.

Carsten Conrad thekson se qëllimi i përbashkët duhet të jetë “punësimi”. Ai sqaron se “facility management” në Shqipëri nuk është i zhvilluar, ndaj edhe pas realizimit të ndërtimit të Tirana Business Park do të ketë sërish nevojë për kualifikim në përvetësimin e profesioneve të tjera. Për të sjellë investitorë të huaj në Shqipëri, TBP ka nevojë për personel të kualifikuar në marketing.

## Komenti

*Jens Ströber*, drejtor ekzekutiv i Ems APO (Albanian Port Operator) dhe prej katër vjetësh i angazhuar në portin e Durrësit, fillimisht me firmën Stauerei ASC (Albanian Stevedoring Company) ishte dakord me të dy prezantimet, për sa i përket disponimit të vendeve të punës. Por biznesi i tij, edhe më tepër se TIA dhe TBP, varet nga niveli i punonjësve të thjeshtë, por edhe i punëtorëve të kualifikuar specialistë. Sipas Ströber, pikërisht këta punonjës specialistë të kualifikuar janë mungesa më e madhe në Shqipëri. Ai përmend edhe disinformimin e plotë që iu bëhet të rinjve shqiptarë në lidhje me vlerën e disa ofertave arsimore të natyrës (pseudo)akademike, të cilat nuk kanë asnjë dobi për karrierën e mëtejshme të këtyre të rinjve.

## Diskutimi

Në diskutimin vijues theksohet se infrastruktura, ndërtimi dhe logjistika janë tre sektorë, të cilët tërheqin edhe numrin më të madh të investitorëve të huaj drejt Shqipërisë dhe këtë pozicion këta sektorë do ta ruajnë edhe në terma afatmesëm. Bizneset vijnë nga sektori i ndërtimit të rrugëve, punimeve publike (porti, aeroporti), ndërtimet e urave, facility management, teknike sigurie dhe logjistikë transportesh.

Në këta sektorë nevojiten specialistë në të gjitha nivelet: nga punonjës ndihmës i nivelit të ulët, te punonjësi specialist (teknik), nga zanatçiu i kualifikuar tek inxhinierët për sigurinë teknike, te logjistika dhe drejtimi i ndërtimeve, nga asistentët në zyrë te specialistët e administrimit (teknologjia e informacionit, planifikimi logjistik). Spektri i personelit që nevojitet është shumë i gjerë dhe madje i krahasueshëm me bizneset prodhuese.

Përfaqësuesit e biznesit të pranishëm në panel tërheqin vëmendjen se në shumicën e rasteve nuk ka oferta në tregun e punës, të cilat mund t'i përgjigjen kërkesave të mësipërme. Ndaj shpesh bizneset detyrohen të marrin në punë specialistë të huaj apo t'i trajnojnë vetë punonjësit specialistë.

### Gjetjet kryesore

- Shkollat profesionale ekzistuese – shpesh shumë të vogla – janë në sasi dhe në cilësi të pamjaftueshme për kërkesat e cilësisë së një ekonomie moderne në Shqipëri. Duhet të nisë ndërtimi i një sistemi të arsimit profesional modern në të gjithë vendin.
- Nxënësit në shkollat dhe qendrat profesionale trajtojnë shumë më tepër tema të rëndësishme dhe merren shumë pak me përvetësimin e shprehive praktike.
- Krijimi i një bashkëpunimitë mirë ndërmjet kompanive dhe shkollave profesionale, këto të fundit nuk do të kishin nevojë domosdoshmërisht për pajisje më të shtrenjta, pasi këto mund të bashkëfinancoheshin nga kompanitë në të mirë të të dyja palëve.
- Duke qenë se qeveria shqiptare i ka të kufizuara fondet në këtë drejtim, i duhet dhënë prioritet bashkëpunimit të ngushtë me sektorin privat për ta zgjidhur këtë problem.
- Të rinjtë në Shqipëri nuk e njohin nevojën për kualifikime në ekonominë e lirë. Ata shpesh marrin vendimet e gabuara për arsimimin dhe karrierën e tyre. Këshilluesit më të rëndësishëm në të tilla raste janë ende prindërit. Ndaj duhet të zhvillohen fushata informimi dhe sensibilizimi për të rinjtë dhe prindërit e tyre.
- Shembull tipik i aspiratave të keqorientuara profesionale janë universitetet e tejmbushura në të gjitha qytetet, qofshin këto private apo publike. Vetëm një numër shumë i vogël i studentëve që përfundojnë këto universitete gjejnë mundësi punësimi në përputhje me kualifikimet e tyre.
- Kompanitë e huaja sqarojnë se për rekrutimin e punonjësve ata shfrytëzojnë shërbimet online dhe gazetatat. Pozicionet drejtuese rekrutohen nëpërmjet kompanive të posaçme. Deri më tash ka munguar një politikë aktive punësimi, e cila të përfshijë të gjithë punëkërkuarit dhe punëdhënësit.
- Sistemi arsimor në tërësi duhet reformuar thellësisht. Domosdoshmëri është integrimi i teorisë me praktikën bazuar në mësimnxënien nëpërmjet proceseve.
- Ngritja e një sistemi adekuat të kualifikimeve profesionale kërkon kohë për të arritur suksese të dukshme.

## Prezantim:



## Qendra Multifunktionale e Kamzës - Partner në industrinë e trajnimit profesional, transferimit të teknologjisë dhe shërbimeve

Një nga vështirësitë më të mëdha të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë është arsimit dhe formimi profesional i popullsisë. Sistemi shqiptar i arsimit dhe formimit profesional nuk e ndjek mjaftueshëm tregun e punës dhe nuk përmbush nevojën për fuqi punëtore të kualifikuar. Kjo vlen si për arsimin profesional fillestar, ashtu edhe për formimin profesional dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës. Vitet e fundit janë ndërmarrë nisma për reforma, të cilat janë përqendruar në probleme tradicionale si: hartimi i kurrikulave, kualifikimi dhe trajnimi i mësuesve dhe instruktorëve si dhe pajisja me infrastrukturë e shkollave profesionale. Njëkohësisht janë vendosur themelet për një reformim të mëtejshëm të sistemit të arsimit profesional.

Prej vitesh, GIZ mbështet me konsulencë reformën e arsimit profesional shqiptar (në hartimin e Ligjit të Arsimit dhe Formimit Profesional, hartimin e Strategjisë së Arsimit dhe Formimit Profesional, zhvillimin e shkollës etj.). Në këtë kuadër është planifikuar edhe mbështetja për zhvillimin e konceptit dhe të ndërtimit të së ashtuquajturës Qendër Multifunktionale (QMF), model i cili në të ardhmen do të jetë një shtyllë e rëndësishme në sistemin shqiptar të arsimit profesional. Në nivel institucional, GIZ ofron konsulencë për institucionet përgjegjëse rreth zhvillimit të organizatës, hartimit të kurrikulave, zhvillimit të provimeve/certifikimit, zbatimit të instrumenteve të BE-së, kualifikimit dhe trajnimit të stafit mësimor në arsimin profesional, bashkëpunimit me biznesin, konceptet e reja të drejtimit si dhe në proceset e njohjes së dijeve të mëparshme.

Në nivel zbatues, GIZ fokusohet në përcjelljen e njohurive dhe shprehive në zona të ndryshme pilot (Qendra Multifunktionale Kamzë si dhe në gjashtë shkolla të mesme profesionale në Shqipëri Verilindore), njohuri dhe shprehje të cilat janë të nevojshme për konceptimin dhe zhvillimin e një arsimit dhe formimi profesional më të orientuar drejt punësimit në sektorë në rritje të ekonomisë. Konsulenca ofrohet në hartimin e përshkrimeve të kualifikimeve dhe kurrikulave me sektorin privat për arsimin profesional fillestar dhe kurset e formimit profesional në drejtimin teknologji informacioni, mekatronikë, profesione të kujdesit shëndetësor si dhe të teknikës dhe teknologjisë së automatizimit.

Njëkohësisht drejtuesit e institucioneve arsimore kualifikohen në çështje të menaxhimit të shkollës, menaxhimit të cilësisë, planifikimit të nevojave për burime njerëzore, bashkëpunimit me biznesin dhe në marketing/PR. Mësuesit në drejtimet e përzgjedhura trajnohen në aspektin teknik-përmbajtësor dhe metodik-didaktik. Mbështetja ofrohet edhe në hartimin e materialeve mësimore, udhëzuesve të provimeve, në këshillimin për karrierë si dhe në hartimin e materialeve informuese për realizimin e fushatave të marketingut dhe imazhit të shkollës.

### Qendra Multifunktionale Kamzë

Synimi kryesor i ngritjes së Qendrës Multifunktionale është përpjekja për arritjen e kërkesave dhe nevojave të sektorëve të rëndësishëm ekonomikë në Shqipëri duke përgatitur punonjës të kualifikuar. Një faktor suksesi është plotësimi i “dijes përse” me “dijen si” në fushat përkatëse.

Qendra Multifunktionale Kamzë do të vërë në dispozicion një ofertë të gjerë arsimit dhe formimi profesional dhe shërbime si:

- Arsimit profesional disavjeçar në nivelet I – III (kohëzgjatja 2 deri në 4 vjet)
- Kualifikime afatshkurtra për bizneset në bazë të kërkesës
- Arsimit profesional të pasmesëm
- Programe të trajnimit të trajnerëve
- Mbështetje për industrinë e vogël e të mesme nëpërmjet konsulencës dhe shërbimeve teknike

QMF Kamzë e ka intensifikuar aktivitetin e vet këtë vit, është transferuar në një ndërtesë të re, ka rritur numrin e nxënësve nga fillimisht 650 në 1200 dhe po pajis laboratorët dhe punëtoritë me infrastrukturë sipas standardeve të kërkuara.

Ky institucion ofron aktualisht nëntë drejtime të arsimit profesional, nga të cilat bashkëpunimi gjerman përqendrohet kryesisht në këto drejtime:

- Mekatronik                                      elektro-auto mekanik shërbimi, mekanik motori
- Shoqëror dhe shëndetësor                      kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit
- Teknologji informacioni                        teknik rrjeti, teknik zbatues, teknik dizajni
- Hoteleri-turizëm                                    bar dhe restorant

Gjithnjë e më tepër përfshihen kompani dhe ndërmarrje në kualifikimin praktik me qëllim që hap pas hapi të ndërtohet një sistem arsimimi kooperativ. Vetëm në këtë mënyrë mund të ulen kostot e jashtëzakonshme të arsimit profesional dhe mund të garantohet kualifikimi sipas kërkesës dhe nevojave të ekonomisë.

## Prezantim:



## PASO në Shkollë - lidhja e parë me biznesin / komunitetin

**Projekti Albiz – “Reforma e Arsimit të Mesëm Ekonomik në Shqipëri 2009 - 2013”**, financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe zbatuar nga KulturKontakt Austria, me një buxhet 828.565 Euro mbështet drejtpërdrejt shkollat e mesme profesionale në drejtimin ekonomi-biznes në qytetet: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Lushnjë, Korçë, Berat, Shkodër, Lezhë, Peshkopi, Sarandë dhe Pogradec. Projekti synon të kontribuojë në reformën e arsimit profesional, për ta afruar atë me tregun e punës, për ta bërë më tërheqës dhe për t'i përshtatur profilet arsimore me kërkesat e ekonomisë shqiptare nëpërmjet ndërhyrjes në gjashtë komponentë:

1. Zhvillimi dhe garantimi i cilësisë së shkollave
2. Menaxhimi modern i shkollave
3. Përshtatja e kurrikulave shkollorë me tregun rajonal të punës
4. Trajnimi i mësuesve rreth metodave moderne të mësimdhënies
5. Vendosja e një rrjeti bashkëpunimi me biznesin
6. Integrimi gjinor

Për realizimin e komponentit të 5-të, në secilën shkollë të projektit u vendos një mësues koordinator për marrëdhëniet me partnerët socialë – Paso, i cili u përzgjedh nga drejtuesi i shkollës në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Aftësi shumë të mira komunikimi, të punës në grup dhe frymëzues bashkëpunimi
- Kuptim të mirë të gjendjes ekonomike në tërësi dhe rajonale në veçanti
- Kuptim të mirë të dinamikave të biznesit
- Mësues i shkollës, mundësisht mësues specialist i lëndëve profesionale

Me një Urdhër të posaçëm të Ministrisë së Arsimit, mësuesit Paso kanë përfituar një reduktim prej 4 orësh mësimore në javë në mënyrë që të realizojnë detyrat e këtij roli, të tilla si:

- Vendos lidhje të reja me bizneset dhe partnerët lokalë dhe mban kontakte me ata ekzistues.
- Koordinon takime, vizita për nxënësit në ambientet e bizneseve.
- Krijon lidhje/kontrata për realizimin e praktikave të nxënësve të shkollës.
- Organizon takime dhe diskutime me biznese të rajonit për zhvillimin e përmirësimin e kurrikulave në bazë shkolle.

Gjatë kësaj kohe janë realizuar në total 44 ditë të dyerve të hapura (aktivitete promovuese), 12 takime mes tyre për qëllime trajnimi, shkëmbim eksperiencash dhe 5 konferenca rajonale me biznesin në: Tiranë, Sarandë, Vlorë, Lezhë dhe Korçë.

### Takime

Mësuesit Paso janë trajnuar nga Business Coach rreth: a) marketingut të shkollës, përmirësimit të aftësive komunikuese e prezantuese, organizimit të aktiviteteve, njohjen e parimeve të biznesit etj.

### Projekte bashkëpunimi shkollë-biznes

Në Lezhë është realizuar konkursi i planit më të mirë të biznesit me një juri të përbërë prej 5 përfaqësuesish nga biznesi. Në këtë aktivitet u prezantuan 10 plane biznesi dhe juria përzgjedhi 3 më të mirët, si dhe përcolli disa konkluzione dhe sugjerime të vlefshme për nxënësit.

Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë realizoi aktivitetin 1-javor “Ditët e Raiffeisen”. U organizuan vizita në ambiente të ndryshme të bankës për të gjithë nxënësit e viteve të 3-ta dhe 4-ta. Punonjës në nivele drejtuese në bankë vlerësuan konkursin me pyetje që shpall fitues një nga 4 grupet pjesëmarrëse. Fituesit patën mundësinë të realizonin një praktikë dy javore në zyrat qendrore të Bankës Raiffeisen. Në kuadër të këtij projekti, Banka i dhuroi shkollës pajisjet kompjuterike për një zyrë firme ushtrimore.

Në Korçë kompania Sigal realizoi një projekt me nxënësit për promovimin e sigurimit të jetës së nxënësve. Edhe ky aktivitet u realizua si një konkurs, ku fituesi përfitoi një praktikë dy javore pranë kompanisë.

### Konkluzione

- Puna e Paso-s ka përmirësuar mundësitë e **të nxënësve praktik falë intensivimit të angazhimit të biznesit në shkollë.**
- Mësuesit Paso kanë reflektuar **përmirësim të dukshëm të aftësive organizative, menaxhuese, komunikuese.**
- **Angazhimi dhe mbështetja e ministrisë përkatëse** për rolin e Pasove do të përbëjë një hap thelbësor në konsolidimin dhe suksesin e këtij roli.
- **Formalizimi** dhe prezantimi i këtij roli në të gjitha shkollat e mesme profesionale do të krijojë një rrjet më të fuqizuar dhe një bashkëpunim më të frytshëm shkollë – biznes.

## Prezantim:



### “Mendimtarët” dhe “Praktikët” të përfshirë në sistemin Dual

Universiteti Nehemiah Gateway është një ndër institucionet e para arsimore në Shqipëri që ka përdorur një kombinim të teorisë me praktikën në kurrikulën e tij: studimin dual, ose sistemin e dyfishtë. Pas tre vitesh eksperiencë ka shumë praktika të mira për t’u treguar dhe ende shumë sfida për t’u kapërcyer si rezultat i një eksperiencë jetësore në vendet në zhvillim dhe në kërkim të një përpjekje të ndershme për të mbështetur në mënyrë të qëndrueshme një komb vital si Shqipëria në rrugën e progresit në fushën arsimore dhe ekonomike.

Arnold Geiger e përshkruan situatën sfiduese si një boshllëk ndërmjet dy grupeve njerëzish:- nga njëra anë janë personat inteligjentë dhe shumë të arsimuar, të cilët ai i quan “mendimtarë”, ose të njohur ndryshe si “akademikë”, të cilët zhvillojnë ide, por nuk i ndihmojnë shumë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në punën e tyre të përditshme, dhe nga ana tjetër janë njerëzit me njohuri praktike për shkak të eksperiencës së tyre, të cilët mësojnë duke bërë, e të cilët ai i quan “bërës” ose “praktikë”, por që shpesh nuk kanë standard të lartë të njohurive dhe trajnimeve të nevojshme teorike.



Në të dy grupet ka histori suksesi dhe dështimesh të admirueshme që duhet të shqyrtohen dhe nga të cilat duhet të nxirren mësimet.

Në mënyrë që të dy aktorët të bëhen pjesë e skemës (pra dhe “mendimtarët” dhe “praktikët”), Universiteti Nehemiah Gateway ka përdorur një model arsimor të provuar, të quajtur “studime duale” ose “studime të dyfishta”. Për shkak të reputacionit për mangësitë e “praktikëve”, Universiteti është përpjekur të tërheqë të rinj me studime të dyfishta në nivelin universitar. Sistemi i studimeve të dyfishta është një kombinim i teorisë dhe kohës së praktikës gjatë tre viteve të studimit. Këto studime sjellin së bashku universitetin dhe kompanitë ku zhvillohen praktikatat e rregullta mësimore. Universiteti “Nehemiah Gateway”u hap në vitin 2008, ndërkohë që në vitin 2010 filloi studimet grupi i parë pilot i studentëve të biznesit dhe ekonomisë duke iu nënshtruar studimeve të dyfishta “të modifikuara”.



Nëpërmjet kësaj qasje Universiteti solli së bashku dy aktorë normalisht të ndryshëm (pasi ata janë të tillë në mënyrë të natyrshme në tregun e punës). Pas zbatimit të sistemit të studimeve të dyfishta. Universiteti u has me disa sfida, nga të cilat ai mësoi shumë. Kompanitë lokale nuk janë ende gati për të trajnuar studentët e rinj. Nga ana tjetër, institucionet arsimore duhet të kenë një kuptim më të mirë të nevojave të kompanive dhe të mundohen t’i përfshijnë ato edhe më shumë në zhvillimin e studimeve të dyfishta. Në fund të fundit, studentët kanë nevojë të gjejnë një vend pune mundësisht në kompaninë ku kanë bërë trajnimin praktik.

Një sfidë tjetër është mungesa e statusit ligjor të “praktikantit”. Ky status zyrtar do t’i ndihmonte studentët gjatë praktikës së tyre në një kompani të paguheshin, duke pasur kështu mundësi të financonin studimet dhe të ndihmonin kompanitë të merrnin në punë studentë me një status që do t’i lehtësonte ata financiarisht.



Sipas eksperiencave të mbledhura nga Universiteti Nehemiah Gateway, Arnold Geiger përcaktoi katër hapa për të forcuar këtë kombinim të teorisë me praktikën në sistemin arsimor shqiptar:

- rritjen e interesit dhe përfshirjen e kompanive lokale,
- organizimin e tyre në dhoma funksionale,
- krijimin e një statusi ligjor për praktikantët,
- forcimin e imazhit dhe të statusit të “praktikut”, ose të “bërësit” në shoqëri dhe në sytë e të rinjve.

Së fundmi, duke menduar në mënyrë strategjike dhe të qëndrueshme, mendimi i të kombinuarit të teorisë me praktikën nuk duhet të fillojë vetëm në universitete, por që në fazat e hershme në shkollat shqiptare. Kjo jo vetëm që do të sfidojë formulën e njohur  $1+1=2$ , por dhe do të provojë që  $1+1 > 2$  në përfitim të shoqërisë. Kombinimi i formimit praktik me bazën akademike teorike do të ndihmojë për të arsimuar më mirë të rinjtë në Shqipëri dhe, për rrjedhojë, për të përmirësuar zhvillimin ekonomik në Shqipëri.

## Prezantim:



## Të nxënësit bazuar në projekt

Shqipëria po kalon ndryshime dhe reforma domethënëse në shumë fusha. Vendi ka për qëllim të lëvizë drejt integritimit evropian, por ka ende shumë për të bërë në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror. Shqipëria është ende një ndër shtetet më të varfra në Evropë dhe mundësitë e të rinjve për të gjetur punë me përfitime janë ende të kufizuara. Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP) është një ndër fushat që ka nevojë për më shumë përpjekje dhe mbështetje. Në të njëjtën kohë, formimi profesional ka potencial të konsiderueshëm për të nxitur ekonominë dhe për të dhënë një kontribut domethënës për t'i futur njerëzit në tregun e punës.

### Projekti AlbVET 2007-2014

Shqipëria ka një popullsi të re në moshë dhe nivel të lartë papunësie ndërmjet të rinjve, por në të njëjtën kohë ajo ka mungesa të mëdha të krahut të kualifikuar të punës. Për sa i përket orientimit në tregun e punës, cilësisë dhe aspektit praktik, pjesa më e madhe e sistemit arsimor të mbështetur tek shkollat është e papërshtatshme. Kjo ka qenë pika e nisjes për projektin AlbVET, i cili është drejtuar nga Sëisscontact që prej vitit 2007 në emër tëSDC-së.

Në kuadrin e reformës së përgjithshme të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, projekti i kushton rëndësi të veçantë sektorëve të përzgjedhur kyç. Vëmendja përqendrohet tek forcimi i strukturave lokale, marrja në punë dhe menaxhimi i stafit mësimor me kualifikimet e nevojshme. Për më tepër, projekti kontribuon në mënyrë aktive për zhvillimin e mëtejshëm të politikave të arsimit dhe të formimit profesional dhe për mbështetjen e legjislacionit. Ndryshe nga sistemi arsimor, i cili i mbijetoi tranzicionit nga ekonomia e planifikuar në ekonominë e tregut, sektori i formimit profesional e humbi legjitimitetin e tij brenda natës me zhdukjen e korporatave shtetërore dhe të tregjeve përkatëse të punës. Për pasojë, këtij sektori iu desh të ndërtohej nga zeroja.

Ky zhvillim i ri i përqendruar tek tregjet e reja të punësimit edhe sot që flasim, njëzet vjet nga fillimi i tranzicionit, është ende në fazën e tij fillestare. Në zbatimin e këtij ndryshimi, Swisscontact punon në të gjithë vendin me më shumë se njëzet ofrues trajnimesh shtetërore dhe private, me autoritetet e formimit profesional dhe me organizatat jo-qeveritare. Projekti i kushton rëndësi të veçantë novacionit, profesionalizmit, dhe formimit me aspekte praktike, si dhe institucionalizimit dhe qëndrueshmërisë.

### Faza e ndërhyrjeve 3

- reforma e gjerë në vend e të gjithë sektorit të tregtisë (ngrohjes, ajrit të kondicionuar dhe tubacioneve dhe aparaturave, duke përfshirë dhe teknologjinë diellore). Strategjia e të nxënësit bazohet në të nxënësit në bazë projekti;
- trajnimi profesional fillestar pas shkollës së mesme për profesionistët e IT-së me ambiente të dyfishta për nxënie, bazuar në një bashkëpunim institucional ndërmjet një universiteti dhe një shkolle profesionale;
- stimulimi dhe mbështetja e iniciativave lokale për trajnimin e fillestarëve me aftësi tradicionale.

Ndërhyrja 'Coach for Employment' (mbikëqyrje për të pasur aftësitë e ndryshme për të gjetur punë) i ndihmon pakicat, në veçanti romët e rinj, të integrohen në tregun e punësimit. Për qëndrueshmëri, projekti nxit modelet e reja të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve private dhe publike.

### Grupi i synuar

Nxënës, të rinj, pakica që kanë mbaruar shkollën e mesme

## Sistemi dual dhe çfarë mund të mësojmë prej tij!



### Sabine Hartig

Drejtuuese e Programit për Trajnimin dhe Arsimin Profesional, GIZ

#### Konteksti

Arsimi dhe formimi i dyfishtë profesional, sipas modelit të praktikës së suksesshme gjermane, po vjen duke u bërë gjithnjë e më i njohur në Shqipëri. Kjo mund të shihet qartë dhe nga Programi i Qeverisë 2013-2017, i botuar së fundmi nga qeverisja e re e drejtuar nga Partia Socialiste, e cila ka filluar nga puna në shtator 2013. Me një nivel papunësie prej më pak se 8% të personave më të rinj se 25 vjeç, Gjermania është goxha përpara shteteve të tjera europiane për të njëjtin tregues. Nga njëra anë, ky fenomen ka ardhur për shkak të ekonomisë së fortë dhe të sektorëve ekonomikë që kërkojnë krah pune të trajnuar dhe me aftësi, ndërsa nga ana tjetër, përqindja e lartë e të rinjve të punësuar është po ashtu pasojë e drejtpërdrejtë e sistemit të formimit të dyfishtë në Gjermani.

#### Karakteristikat e sistemit dual

Ashtu si edhe në shtete të tjera, sistemi i arsimit dhe formimit profesional në Gjermani nuk bazohet ekskluzivisht tek sistemi i dyfishtë (pra tek formimi si në shkollë dhe në vendin e punës). Por, pavarësisht nga kjo, sistemi i dyfishtë mbetet themeli i sistemit të arsimit dhe formimit profesional gjerman. Më shumë se 50% e të rinjve të një grup moshe të caktuar trajnohen sipas kësaj skeme. Karakteristika kryesore e skemës është që si ndërmarrjet dhe shkollat ndajnë së bashku përgjegjësitë e trajnimit. Formimi realizohet në dy ambiente të ndryshme trajnimi, ku formimi në ndërmarrje luan rolin kryesor. Sistemi i formimit të dyfishtë ka reputacion shumë të mirë jo vetëm në shoqëri në përgjithësi, por veçanërisht ndërmjet të rinjve. 20% e të diplomuarve nga shkollat e mesme, të cilët kualifikohen për të vijuar arsimimin e tyre në universitete, zgjedhin t'i nënshtrohen sistemit të dyfishtë të arsimit profesional. Qëllimi i sistemit të arsimit të dyfishtë AFP është që të ofrojë kualifikimet, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar një profesion si punëtor me eksperiencë ose punonjës i specializuar. Praktikanti mund të mësojë të përballet me kërkesat gjithnjë e më ndryshim të punës së tij/saj vetëm nëpërmjet formimit të bërë në vendin e punës. Formimi i bërë në vendin e punës nxit pavarësinë dhe përgjegjshmërinë, të cilat janë cilësi të padiskutueshme në një shtet të zhvilluar industrial ose të bazuar në shërbime.

#### Organizimi i formimit dual

Trajnimi i dyfishtë për t'u kualifikuar në një profesion kërkon nga 2 deri në 3,5 vjet. Si rezultat, formimi brenda kompanisë përbën 60-80% të kohës së përgjithshme të trajnimit. Për t'u trajnuar në industri, kërkohet që praktikanti të nënshkruajë një kontratë formimi me një ndërmarrje. Kontrata përfshin të drejtat dhe përgjegjësitë e të dyja palëve, si dhe pagesën për trajnim që paguhet nga kompania punëdhënëse. Kompania trajnon bazuar në një plan të përcaktuar trajnimi, i cili bazohet në një rregullore formimi të miratuar nga shteti. Për shkak të zhvillimeve teknologjike gjithnjë e më ndryshim, përmbajtjet e trajnimeve janë bërë gjithnjë e më shumë komplekse me kalimin e kohës, në veçanti në fushën e formimit industrial. Në rastet kur trajnimet specifike nuk mund të inkuadrohen në proceset e prodhimit, kompanitë mesatare dhe të mëdha zakonisht ofrojnë kurse specifike formimi. Për këtë arsye, ato kanë krijuar punëtorë për trajnime të posaçme. Kompanitë më të vogla jo domosdoshmërisht mund të përballojnë krijimin e ambienteve të posaçme për këtë qëllim, kështu që dhomat dhe shoqata profesionale kanë instaluar punëtorë trajnimi që mund të përdoren nga kompanitë e tyre anëtare. Vetëm personeli që i ka dëshmuar aftësitë e tij teknike dhe personale për të trajnuar ka të drejtë të luajë rolin e trajnuesit për arsimin profesional. Urdhëresa për Aftësitë e Trajnuesit trajton kushtet për njohjen e trajnuesit për arsimin profesional. Arsimi në një shkollë profesionale me kohë të pjeshme përfshin dhe kualifikim praktik. Detyra e shkollës profesionale është që të zgjerojë arsimin e përgjithshëm të marrë më parë (rreth një e treta e trajnimit) dhe të ofrojë njohuri bazë dhe të specializuara profesionale (rreth dy të tretat e trajnimit).

#### Drejtimi, partnerët dhe përgjegjësitë e përbashkëta në sistemin dual

Sistemi i dyfishtë i arsimit dhe formimit profesional bazohet në bashkëpunimin ndërmjet ekonomisë shtetërore dhe private, të trajtuara si dy partnerë të barabartë. Nëpërmjet të ashtuquajturit Akt i Arsimit dhe Formimit Profesional, i cili parashikon rolin e secilit aktor në arsimin dhe formimin profesional, shteti krijon kuadrin ligjor për zbatimin e arsimit dhe formimit profesional. Kurrikula kuadër, baza për arsimin dhe trajnimin profesional në shkollat profesionale janë zhvilluar dhe miratuar bashkërisht nga ministrat e arsimit të 16 shteteve federale. Kurrikulat kuadër janë të harmonizuara me rregulloret përkatëse të formimit për trajnimin brenda kompanisë. Fakti që rregulloret e formimit si dhe kurrikula kuadër janë të miratuara në nivelin kombëtar garanton që në të gjithë vendin zbatohen të njëjtat standarde. Dhomat, shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat ose përfaqësuesit e punëmarrësve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sistemin e dyfishtë. Shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat kontribuojnë në nivelin kombëtar për projektimin dhe zhvillimin e pozicioneve trajnuese dhe rregulloreve për trajnimet, ndërsa Dhomat, si "organet kompetente" në nivelin vendor, mbikëqyrin trajnimin në kompani, organizojnë provimet përfundimtare dhe japin certifikatat përfundimtare. Ato financohen nga kontributet e detyrueshme nga anëtarët e tyre dhe nga fondet e shtetit.

## Kostot dhe financimi i sistemit dual

Në vitin 2010, kostot bruto për trajnimin e dyfishtë në Gjermani vlerësoheshin në rreth 31.6 miliardë euro, 75% e të cilave financoheshin nga kompanitë e formimit (pagesa për trajnim, trajnues, pajisje, artikuj konsumi, dhe ambiente shtesë trajnimi) dhe vetëm 25% (shkolla, fonde) nga shteti. Gjithsesi, studimet kanë dëshmuar se një pjesë e madhe e këtyre kostove mbulohej nga fitimi nga investimi i realizuar nëpërmjet formimit (kontributi produkti i të trajnuarit, kosto më të vogla rekrutimi, etj.). Mesatarisht, kostot neto të formimit brenda kompanisë shkojnë në vetëm 25% të kostove të përgjithshme neto të krijuara. Kostot korrente neto ndryshojnë në varësi të fushave të trajnimit.

## Faktorët e mposhtëm konsiderohen si thelbësorë për funksionimin e sistemit të dyfishtë të arsimit profesional:

- një konsensus i gjerë në shoqëri për t'u ofruar të gjithë personave që e lënë shkollën mundësinë e arsimit dhe formimit profesional;
- gatishmëria e ndërmarrjeve për të investuar në arsimin dhe trajnimin profesional për brezin e ardhshëm;
- një Akt Arsimit dhe Formimi Profesional që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve
- gatishmëria e sektorit publik (qeverisë, shkollave) për ta pranuar sektorin privat si partner të barabartë në arsimin profesional;
- gatishmëria e sektorit privat për të pranuar kontrollin e cilësisë së aktiviteteve të tij të formimit
- një vendim strategjik nga lart-poshtë nga qeveria dhe punëdhënësit për të zbatuar sistemin e dyfishtë.

## Përfitimet e sistemit dual

Kompanitë e formimit e konsiderojnë si një ndër avantazhet kryesore të formimit të dyfishtë faktin që ata janë në gjendje të trajnojnë punonjësit e tyre bazuar në kërkesat specifike të kompanisë, dhe të krijojnë në këtë mënyrë kompetencat që nevojiten për të mbetur konkurrues në treg në kuadrin afatgjatë. Formimi i dyfishtë ul kostot e rekrutimit dhe kostot e "bërjes pjesë e kompanisë". Për më tepër, i trajnuari është produktiv që gjatë formimit dhe kontributi i tij/saj mbulon të paktën një pjesë të kostos së trajnimit. Së fundi, por jo nga rëndësia, për të kontribuar aktivisht për zhvillimin e aftësive për brezat e ardhshëm, ky lloj kontributi konsiderohet si shprehje e përgjegjësisë së bizneseve ndaj shoqërisë dhe ka ndikim pozitiv në imazhin e kompanisë që ofron trajnimin. Nga perspektiva e shtetit dhe e shoqërisë, formimi i dyfishtë është mekanizmi kryesor për ruajtjen e standardeve kombëtare të formimit dhe për sigurimin e mobilitetit të përgjithshëm të krahut të punës. Punonjësit dhe punëmarrësit e kualifikuar dhe me kërkesa për vende pune përbëjnë një faktor të fortë konkurrence.

## Hapat drejt një sistemi dual formimi

Shembulli i Gjermanisë tregon se duhet të krijohen kushte të ndryshme për të siguruar suksesin e një sistemi të dyfishtë trajnimi. Shqipëria mund t'i referohet po ashtu dhe sistemit të arsimit profesional në të shkuarën e saj, i cili kombinonte fort në trajnimin praktik në ndërmarrje, të kombinuar me arsimin plotësues profesional në shkollat profesionale. Reforma aktuale e sistemit të arsimit dhe formimit profesional mund të mbështetet në këto eksperiencë. Cilët mund të jenë hapat e parë drejt një sistemi të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, i cili bazohet në qasjen e sistemit të dyfishtë?

- Së pari, shkollat e arsimit profesional duhet të bëjnë fushatë në nivelin lokal për të pasur akses tek sa më shumë kompani që të jetë e mundur, ku mund të çohen praktikantët të rinj për praktike mësimore.
- Së dyti, praktikat mësimore duhet të organizohen përgjatë të gjithë periudhës së formimit në një formë të strukturuar dhe mbi bazën e moduleve. Një praktikë mësimore duhet të bazohet në praktikën e mëparshme. Minimalisht, duhet të parashikohen dy faza praktike pune me nga dy muaj secila. Ndërkohë që praktika e parë mësimore i njeh praktikantët me kërkesat bazë të profesionit, praktikat mësimore më të avancuara do t'i pajisin ata gjithnjë e më tepër me aftësi dhe kompetenca specifike për profesionin. Në të njëjtën kohë, praktika në vendin e punës u jep po ashtu pronarëve dhe menaxherëve të kompanisë mundësinë të dinë se çfarë lloj njohurie profesionale, aftësish dhe kompetencash marrin të diplomuarit nga arsimi profesional dhe t'i vlerësojnë vetë praktikantët.
- Më pas, një hapi i tretë do të ishte zbatimi i sistemit të formimit të dyfishtë me kompaninë e formimit si aktor kryesor, dhe me shkollën profesionale që ofron njohuri shtesë të përgjithshme dhe specifike teorike.
- Për ta bërë sistemin e arsimit dhe formimit profesional tërheqës për të rinjtë, kërkohet të krijohen mundësi karriere brenda sistemit, si për shembull, *arsim dhe trajnim profesional i avancuar* që çon në një kualifikim të njohur, të tillësi "usta", i cili të pozicionohet në një nivel që i korrespondon diplomës tre-vjeçare në Kuadrin Kombëtar të Kualifikimeve. AFT-ja e avancuar mund të organizohet po ashtu në formën e dyfishtë.

## Faktorët e suksesit për trajnimin e dual

Bazuar në eksperiencat e sistemit të dyfishtë gjerman, faktorët karakteristikë të sistemit të formimit të dyfishtë dhe që kontribuojnë për suksesin e tij mund të përkufizohen si më poshtë:

- Të nxënës brenda procesit të punës: formimi brenda kompanisë forcon njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që nevojiten për të përbushur në mënyrë të suksesshme kërkesat e profesionit, të cilat janë gjithnjë e më ndryshim.
- Stafi i kualifikuar i arsimit dhe formimit profesional: Mësues të kualifikuar dhe shumë të motivuar (shkolla të arsimit profesional) dhe instruktorët (kompanitë) mund të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet për të trajnuarit.
- Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe ndërmarrjeve: ka interesa të përbashkëta të integruara në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të AFP-së. Shteti dhe sektori ekonomik marrin pjesë të dy në përkufizimin e standardeve dhe të përmbajtjeve të të nxënës. Kompanitë kontribuojnë financiarisht për kostot e arsimit dhe formimit profesional.
- Pranimi i standardeve kombëtare: njohja dhe përdorimi i standardeve për të cilat është rënë dakord në nivelin kombëtar janë shumë të rëndësishme për cilësinë e lartë të kualifikimeve. Standartet uniforme dhe kualifikimet e krahasueshme forcojnë mundësitë e barabarta dhe lehtësojnë aksesin në tregun e punës.

## **Apel për Vullnet të Mirë**

### **“Ekonomia e Shqipërisë ka nevojë për punonjës të kualifikuar!”**

**Ne apelojmë për një bashkëpunim mes autoriteteve publike dhe sipërmarrësve**

- **Zgjidhimi i potencialeve ekonomike të Shqipërisë!**  
Ekonomia Shqiptare ofron mjaft potenciale të pashfrytëzuara. Në mënyrë që të përdoren këto potenciale nevojiten punonjës me shprehje dhe kualifikim të mirë në të gjitha nivelet e prodhimit, shërbimit dhe administrimit.
- **Shprehje më të mira në të gjitha profesionet!**  
Studimet e orientuara drejt praktikës dhe trajnimit profesional në sektorin jo-akademik, janë shumë të rëndësishme. Njohuritë teorike duhen kombinuar me eksperiencat praktike në mënyrë që të zhvillohen aftësi të mira të punonjësit si dhe të jenë bashkëpunues aktivë dhe kreativë për një ekonomi shqiptare moderne.
- **T'i japim rinisë një perspektivë!**  
Të rinjtë shqiptarë me shprehje, kompetenca dhe kreativitet të lartë, janë një potencial i shkëlqyer për të ardhmen e vendit. Kompanitë mund të jenë konkurrese në tregjet ndërkombëtare nëse punonjësit e tyre janë të aftë të prodhojnë produkte dhe shërbime me kualitet të lartë.
- **Ndërtimi i një strukture në nivel kombëtar!**  
Mbështetësit e kësaj iniciative bien dakort të zhvillojnë një strategji në shkallë kombëtare të bashkëpunimit në sektorin e Trajnimit Profesional në Shqipëri bazuar në kualitet të lartë dhe të orientuar në praktikë.
- **Bashkëpunimi i të gjithë aktorëve në tregun e punës!**  
Sektori privat, institucionet publike, kompanitë, shoqatat, federatat dhe dhomat e tregëtisë duhet të bashkëpunojnë fuqishëm dhe si partnerë të barabartë me institucionet për një sektor mbështetës të Trajnimit Profesional.
- **Përdorimi i njohurive ekzistuese dhe ekspertizës së ofruar nga donatorët!**  
Njohuritë dhe eksperiencat e donatorëve ndërkombëtarë në Shqipëri që ofrojnë sisteme të ndryshme trajnimi profesional, duhet të integrohen në strategjinë e VET (Edukim dhe Trajnim Profesional). Konsulenca e tyre dhe praktikimet më të mira duhen shfrytëzuar.
- **Mundësimi i trajnimeve praktike!**  
Mbështetësit e strategjisë së Edukimit dhe Trajnimit Profesional duhet të mundësojnë trajnime ose stazhe praktike afat-gjata. Ata gjithashtu duhet të jenë aktivë në zhvillimin e kurrikulave në nivele të ndryshme, duke përdorur njohuritë profesionale për trajnimin profesional.
- **Sektori privat si një partner i rëndësishëm!**  
Mbështetësit do të ndihmojnë në zhvillimin e bashkëpunimit të modeleve inovative dhe do të integrojnë sektorin privat si një partner të barabartë.
- **Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike!**  
Të gjithë partnerët bien dakort se qëllimi i përbashkët është krijimi i punësimit me dinjitet i sa më shumë të rinjve. Një ekonomi e suksesshme mund të arrihet vetëm nëpërmjet integritetit të trajnimit profesional në të gjitha nivelet.
- **Anëtar i BE, në statusin e një partneri të fortë ekonomik!**  
Mbështetësit e këtij apeli janë të bindur se ekonomia shqiptare do të rritet nëpërmjet forcës së kualifikuar të punës dhe do të jetë kompetente në sektorë të ndryshëm në rajon dhe si rezultat do të jetë një anëtar i respektuar i Bashkimit Evropian.

**Redaktoi:** Frank Hantke, Jonida Smaja

### Autorët

- |  |   |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> Roland Çela, GIZ                  | <input type="checkbox"/> Anette Kasten, DIHA          |
| <input type="checkbox"/> Elsa Denaj, KulturKontakt         | <input type="checkbox"/> Sonila Limaj, Kultur Kontakt |
| <input type="checkbox"/> Arnold Geiger, Fondacioni Nehemia | <input type="checkbox"/> Reiner Reidenbach, GIZ       |
| <input type="checkbox"/> Frank Hantke, FES                 | <b>Raportues të paneleve</b>                          |
| <input type="checkbox"/> Sabine Hartig, GIZ                | <input type="checkbox"/> Migle Brauskaite             |
| <input type="checkbox"/> Winfried Heusinger, CIM/GIZ       | <input type="checkbox"/> Eurgena Topi                 |

---

### Fondacioni Friedrich Ebert në Shqipëri (FES)

Zyra e FES-it në Tiranë është hapur në vitin 1991. Fushat kryesore të aktivitetit tonë janë:

- Shoqëri Civile Aktive:** Ne punojmë me organizata dhe shoqata që janë të angazhuara në mënyrë aktive në zhvillimin shoqëror dhe demokratik të vendit.
- Zhvillimi Social-Ekonomik:** Ne punojmë së bashku me aktorë të ndryshëm në ekonomi. Ne krijojmë platforma dialogimi që kontribuojnë në bilancin e drejtë të interesave dhe rritjes së qëndrueshme.
- Demokratizimi i Institucioneve:** Ne ndihmojmë institucionet të jenë kompetente e të punojnë në mënyrë të pavarur dhe për të mirën e shqiptarëve. Ligjet dhe rregulloret duhet të respektohet nga të gjithë.
- Dialogu dhe pjesëmarrja në botën e punës:** Ne ofrojmë një platformë diskutimi dhe dialogu. Sindikatat duhet të jenë kompetente dhe punëdhënësit mund të gjejnë zgjidhje më të mira për problemet ekonomike.
- E ardhmja e të rinjve:** Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare është nën moshën 30 vjeç. Të rinjtë kanë nevojë për „të pasur zë“, arsim të mirë dhe perspektiva reale. Ata duan dhe mund të ndërtojnë të ardhmen e Shqipërisë.
- Integrimi në BE:** Ne ndihmojmë Shqipërinë për të qënë anëtare e denjë e Bashkimit Evropian sa më shpejt të jetë e mundur. Për këtë ne ofrojmë shkëmbimit rajonal dhe ndërkombëtar përvojash.

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

---

### Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)

Në fund të vitit 2008, u themelua në Shqipëri Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë, e cila ka qenë funksionale që nga mesi i vitit 2009. Ajo përfaqëson rrjetin e kompanive gjermane dhe shqiptare në vend si dhe ndërmjetëson të gjitha kompanitë gjermane të cilët dëshirojnë të hyjnë në tregun shqiptar. Me mbi 60 anëtarë, DIHA është një nga shoqatat më të rëndësishme dypalëshe ekonomike në Shqipëri. Anëtarët e DIHA-s gëzojnë shërbimet e mëposhtme:

- Kontakte:** Avantazhe nëpërmjet rrjetit tonë me organizatat e tjera ekonomike (të biznesit), institucioneve shtetërore dhe kompanive, në Shqipëri dhe Gjermani.
- Rregjistri i anëtarësisë:** Kompania juaj do të listohet në rregjistrin tonë rajonal online të anëtarësisë, i cili shfrytëzohet nga shumë kompani për të krijuar kontakte. Anëtarët kanë akses mbi këto të dhëna (kontakte).
- Rrjetëzim:** Në aktivitetet tona të shumta ju mund të krijoni një rrjet aktiv.
- Përfaqësim interesash:** Shoqata përfaqëson interesat e kompanive gjermane me interesa biznesi në Gjermani.

[www.albanien.ahk.de](http://www.albanien.ahk.de)

